



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

NGA SEANCA PLENARE E KUVENDIT TË KOSOVËS, TË MBAJTUR MË 19
QERSHOR 2008

SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE KOSOVA ODRŽANE 19.
JUNA 2008. GODINE

Qershor – Juni
2008

R e n d i i d i t ë s

1. Miratimi i procesverbaleve të seancave plenare të mbajtur më 2 e 3, 4, 5 dhe 11 qershor 2008,
2. Koha për pyetjet parlamentare,
3. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Armët,
4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-43 për Akreditimin,
5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/48 për Administratën Tatimore dhe Procedurat,
6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjeve për përfitimet e ish-zyrtarëve të lartë,
7. Shqyrtimi i kërkesës së Ministrisë të Ekonomisë dhe të Financave për ridestinimin e mjeteve për investimet kapitale nga Projekti: “Kompleksi i ri Qeveritar” për Projektin: “Rinovimi i Pallatit të Mediave”.

D n e v n i r e d

1. Usvajanje zapisnika sa plenarnih sednica održanih 2, 3, 4, 5 i 11 juna 2008 god,
2. Vreme za poslanička pitanja,
3. Prvo razmatranje N/zakona o oružju,
4. Prvo razmatranje N/zakona o izmeni i dopuni Zakona br. 02/L-43 o akreditovanju,
5. Prvo razmatranje N/zakona o izmeni i dopuni Zakona br. 2004/48 o Poreskoj administraciji i procedurama,
6. Drugo razmatranje N/zakona o prinadležnostima visokih javnih zvaničnika,
7. Razmatranje zahteva Ministarstva ekonomije i finansije o prenameni sredstava za kapitalne investicije iz Projekta” Novi Vladin Komplex” za Projekat “Renovisanje palata medija”.

A g e n d a

1. Approval of the minutes of plenary sessions held on 2, 3, 4, 5 and 11 June 2008.
2. Time for Parliamentary questions,
3. First reading of the Draft Law on Weapons,
4. First reading of the Draft Law on amendments and additions to Law No. 02/L-43 on Accreditation,
5. First reading of the Draft Law on amendments and additions to law No. 2004/48 on Tax Administration and Procedures,
6. Second reading of the Draft Laws on benefits of former senior officials,
7. Review of request made by Ministry of Economy and Finances on re-destination of means for capital investments from Project: “New Government Complex” into the Project for: Renovation of Media Building”.

Seancën e drejtoi Jakup Krasniqi, Kryetar i Kuvendit të Kosovës.

KRYETARI: Të nderuar deputetë,
I nderuar zëvendëskryeministër,
Të nderuar ministra,

Mirë se keni ardhur në seancën e sotme plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës!
Konstatoj se në sallë janë të pranishëm 74 deputetë, që do të thotë se janë plotësuar kushtet për t'ia filluar punës.

Ju njoftoj se në pajtim me rregullat 6.2 dhe 23 të Rregullores së Punës së Kuvendit, Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me grupet parlamentare ka përgatitur dhe Kuvendit ia ka paraqitur rendin e ditës për seancën e sotme plenare.

Ndërkohë, organi i pavarur i përzgjedhjes për përzgjedhjen e anëtarëve të Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik, i formuar me vendim të Kuvendit më 16 maj 2008, ka përfunduar shqyrtimin e kandidaturave të propozuara nga Qeveria për anëtarë të Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik dhe Kuvendit ia ka rekomanduar listën e kandidatëve për emërim.

Për arsye të urgjencës që ka emërimi i Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik propozoj që të radhitet si pikë e fundit e rendit të ditës – Shqyrtimi i rekomandimit të Organit të Pavarur Përzgjedhës për emërimin e anëtarëve të Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik.

Raporti i Organit të Pavarur Përzgjedhës, së bashku me propozimin e Qeverisë u janë shpërndarë deputetëve.

Nga shefat e grupeve parlamentare është paraqitur zoti Lutfi Haziri.

LUTFI HAZIRI: Faleminderit, zoti Kryetar.
Të nderuar ministra.

Më lejoni që për pikën e katërt të rendit të ditës kërkoj tërheqjen nga rendi i ditës, me kërkesë të ministrit të Tregtisë dhe Industrisë, zotit Lutfi Zharku, i cili e ka arsyetuar tërheqjen dhe unë ju lus që ta merrni parasysh kërkesën e tij. Grupi Parlamentar i LDK-së e mbështet kërkesën për tërheqjen e këtij ligji sot, meqë ai është në udhëtim zyrtar. Zëvendësi i tij, po ashtu, është në udhëtim zyrtar dhe besoj që në seancat tjera do të vijë në shqyrtim. Faleminderit!

KRYETARI: Ne e patëm një pikë tjetër të rendit të ditës, do vijmë edhe tek ajo. Ju lutem, unë po i pyes shefat e grupeve parlamentare, a kanë vërejtje? Nuk kanë vërejtje.

Atëherë, kalojmë në votim.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim, për pikën shtesë.

Votojmë tash:

A ka kush që nuk ka kartelë? Kush është “për” nga ata që s’kanë kartela? 3- 4 veta.
Domethënë 41.

A ka “kundër” pa kartela? Nuk ka.

Konstatohet se me 41 vota “për”, 21 “kundër” dhe 7 abstenime vihet në rend të ditës-Shqyrtimi i raportit të Organit të Pavarur Përzgjedhës. Ju faleminderit!

Fjalën për rendin e ditës e ka kërkuar zëvendëskryeministri, Ramë Manaj.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI RAMË MANAJ: Më duket se edhe unë do ta bëja të njëjtin propozim.

I nderuar Kryetar i Kuvendit,

Të nderuar deputetë dhe ministra,

Për shkak të një rrethane objektive, një delegacion qeveritar është në vizitë jashtë vendit në Republikën e Shqipërisë, në përbërje të cilit janë një numër i ministrave të cilët kanë pasur obligim që sot të përgjigjen në pyetjet e deputetëve dhe për shkak se është rrethanë objektive që e arsyeton, unë propozoj që pika e rendit të ditës- Koha për pyetje parlamentare, të shtyhet për seancën e ardhshme. Në fakt, prej të gjitha pyetjeve vetëm një ministër është këtu dhe për një ministër që do të përgjigjet në pyetjet e prezantuara deri më tani mendoj se arsyetohet më shumë të shtyhet për seancën e ardhshme. Po ashtu edhe unë do të propozoja për atë që zoti Lutfi Haziri, shef i Grupit Parlamentar të LDK-së e bëri për tërheqjen e Shqyrtimit të parë të Projektligjit për ndryshimin e ligjit 2004/48 për Administratën Tatimore dhe procedurën. Faleminderit!

(Ndërprerje incizimi)

KRYETARI: Ju lutem, i kemi dy kërkesa, Kërkesën e zëvendëskryeministrit për t'i hequr nga rendi i ditës pikën e dytë dhe pikën e pestë, dhe e kemi kërkesën nga shefi i Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike për heqjen nga rendi i ditës të pikës së katërt, për shkak të mungesës së ministrave që janë në udhëtim zyrtar të planifikuar më herët.

Mirë, më falni, kërkesa është, domethënë, pasi që për prezantimin për pikën e katërt, është i përgatitur zëvendëskryeministri, shkojmë vetëm në kërkesën për t'i hequr nga rendi i ditës pikën e dytë dhe pikën e pestë të rendit të ditës.

Sabri Hamiti, kërkon fjalën.

SABRI HAMITI: Zoti Kryetar i Kuvendit!

U paraqita sepse u befasova në mënyrë të veçantë se si zëvendëskryeministri kërkon të hiqet nga rendi i ditës pika e cila është e paraparë në këtë Kuvend si metodë e kontrollit të Qeverisë. Unë e kuptoj që Qeveria ka dëshirë që kjo pikë për të gjitha kohërat të hiqet nga rendi i ditës, por s'kam menduar që do të dalë me një propozim vetë. Nuk ka kurrfarë arsye dhe nuk duhet të hiqet kjo pikë nga rendi i ditës, në qoftë edhe një ministër përgjigjet sot, qoftë edhe vetëm një pyetje është këtu. I thërras deputetët të mos bien në votime kërkesa të këtilla absurde. A është një pyetje apo 15 pyetje, është punë interesi? Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, shumë për mendimin opozitar, po edhe e respektoj. Ne e kemi kërkesën e arsyetuar të zëvendëskryeministrit dhe unë dua ta hedh në votim dhe nëse deputetët me votim e kundërshtojnë kërkesën e zëvendëskryeministrit, unë s'kam gjë kundër.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash:

Ka qenë për dy pika, për pikën e dytë dhe për pikën e pestë. Ne vazhdojmë, do të thotë, unë s'kam gjë kundër që 36 vota janë "kundër", domethënë të mos hiqet nga rendi i ditës dhe ne vazhdojmë me rend të ditës,
Ju e dini se pikën e pestë të rendit të ditës ne nuk mund ta procedojmë.
Fjalën e ka kërkuar Lutfi Haziri.

LUTFI HAZIRI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Unë mendoj se sigurisht kam nevojë për ta sqaruar zëvendëskryeministrin, njëherë, mirëpo kërkesa e ministrit ka qenë dje që Grupi Parlamentar i LDK-së ta paraqesë dhe ta mbështetë tërheqjen e ligjit që është i sponsoruar nga ai për akreditim. Dhe arsyet nuk m'i ka thënë të tjera, pos asaj që unë i paraqita këtu. Ai nuk është këtu, kërkon që ligji t'i kthehet prapa Ministrisë, në mënyrë që më vonë të vijë në koordinim nga Qeveria në Kryesinë e Kuvendit prapë. Unë ju lus që ta merrni kërkesën e Grupit Parlamentar të LDK-së që vjen nga ministri i Tregtisë dhe Industrisë.

KRYETARI: Atëherë, e kemi kërkesën e shefit të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës Ju lutem nuk ka sqarim, ai është shef i Grupit Parlamentar dhe ka të drejtë ta bëjë mocionin dhe Kuvendi është i obliguar të votojë pa debat për kërkesën e shefit të grupit parlamentar.

(Ndërprerje incizimi)

Ju lutem, edhe një herë kërkoj nga shefi i Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të deklarohej cila është kërkesa, të hiqet nga rendi i ditës apo t'i kthehet Qeverisë?

LUTFI HAZIRI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Të tërhiqet nga rendi i ditës për seancën e sotshme. Faleminderit shumë!

KRYETARI: Ju lutem, kërkesa është që të tërhiqet nga rendi i ditës sot, jo siç vepruat pak më parë. Pra, lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash.

A ka pa kartela? "për"?

Konstatohet se me 66 vota "për", 13 "kundër", 2 abstenime, hiqet nga rendi i ditës pika e katërt.

(Ndërpritet incizimi)

Atëherë, edhe një herë votojmë për pikën e pestë. Jo, pyetja parlamentare ka mbetur në rend të ditës. Pra, nuk mund të bëhet pika kur nuk e kemi ministrin këtu.

(Ndërpritet incizimi)

Ju lutem, çdo propozim do të duhej të shkonte veç e veç për pika. Ne kemi votuar për pikën e dytë të mbetet në rend të ditës dhe jemi dakord. Pika e pestë, unë mendoj që duhet të votojmë, kërkesa është për t'u hequr nga rendi i ditës për të njëjtën shkak që u heq pika katër dhe nuk mund që tash 2 kuti t'i kemi për 2 pika të njëjta të rendit të ditës. Lus deputetë dhe regjinë të përgatiten për heqjen e rendit të ditës të pikës së pestë.

Lus regjinë dhe deputetët për përgatiten për votim. Votojmë tash:

Kush nuk ka kartelë dhe është "për"? 5.

Konstatohet se 60 vota janë “për” A ka “kundër” pa kartelë? Nuk ka. 18 janë “kundër”, 5 abstenime.

Do të thotë, edhe pika e pestë e rendit të ditës hiqet nga rendi i ditës. Faleminderit!

Për rend të ditës fjalën e ka kërkuar deputeti Driton Tali.

DRITON TALI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar të pranishëm,

Unë sot propozoj, pasi që u hoqën disa pika, që t'i shtojmë një dy pika. Nën një, propozoj që sot Parlamenti i Kosovës, institucioni më i lartë legjislativ, të ketë një pikë në rendin e ditës ku do të diskutohet letra e Ban Ki Munit në aspektin e autoritetit të saj legal dhe të një qëndrimi lidhur me atë se cila ka autoritetin mbi tjetrën, Letra e Ban Ki Munit apo Kushtetuta e Kosovës? Siç dihet, Kushtetuta e Kosovës është produkt i negociatave të zhvilluara më se dy vjet, të cilat rezultuan me Paketën apo Dokumentin Gjithëpërfshirës të Presidentit Ahttisari, për çka institucionet kosovare u zotuan se do t'i respektojnë të gjitha pikat që dalin nga ai dokument, në bazë të cilit u hartua Kushtetuta e Kosovës.

Me sa dihet, Letra e Ban Ki Munit nuk ka qenë pjesë e negociatave të Grupit Negociator me palën serbe dhe faktorin ndërkombëtar, do me thanë edhe nuk ka qenë e përfshirë në Dokumentin obligativ gjithëpërfshirës të Ahttisarit. Sipas kësaj logjikisht rrjedh se letra e Ban Ki Munit, e cila nuk është në koordinim me shumë pika në dokumentin e Ahttisarit, si: në polici, drejtësi, dogana, postë-telekomunikacion, nuk është obligative për institucionet e Kosovës, Kuvendi nuk e ka diskutuar dhe votuar apo miratuar. Andaj, mendoj se do të ishte e udhës që Kuvendi të ketë një qëndrim lidhur me Letrën e Ban Ki Munit në aspektin e autoritetit, sepse siç e thashë, është në kundërshtim me Kushtetutën e Kosovës, e cila ka derivuar nga obligimet që i kanë marrë institucionet kosovare nga dokumenti i Ahttisarit. Thënë, ndryshe, deri më tashti dokumenti i Ahttisarit ka pasur autoritetin më të lartë ligjor dhe ne duhet të kemi qëndrim zyrtar se a është edhe më tutje ashtu apo tashti autoritetin mbi atë dokument e ka Letra e Ban Ki Munit, për të cilën, siç e cekën, institucionet ...

KRYETARI: I ke 2 minuta për rendin e ditës dhe kisha kërkuar që, vërtet, unë e çmoj kërkesën tënde, por t'i duhet ta lexosh rregullën dhe në bazë të Rregullores së Punës ta bësh kërkesën tënde me shkrim dhe nuk është mirë, vërtet, t'i e di pse ta kam dhënë fjalën, por e ke zgjatur shumë. Faleminderit!

Për fjalë është lajmëruar deputeti Lutfi Haziri.

Faleminderit, konsultohu me Grupin Parlamentar. Faleminderit!

Kalojmë në pikën e parë të rendit të ditës.

- Miratimi i procesverbaleve të seancave plenare të mbajtura më 2, 3, 4, 5 dhe 11 qershor 2008

Të nderuar deputetë, ju njoftoj se procesverbalet e seancave plenare të mbajtura më 2, 3, 4, 5 dhe 11 qershor 2008, si dhe transkriptet për këto seanca u janë shpërndarë deputetëve.

Pyes deputetët, a kanë vërejtje në këto procesverbale?

Gani Buçinca e ka fjalën.

GANI BUÇINCA: Zoti Kryetar,
Të nderuar deputetë,

Unë kam një vërejtje të vogël në faqen 130. Në diskutimin tim në vend të fjalës “korrupsion” është shkruar fjala “institucion”, prandaj ju kisha lutur të bëhet ky përmirësim. “Në një masë të mirë korrupsioni në Kosovë...” , kurse këtu ka dalë “në një masë të mirë institucioni në Kosovë...” Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Sigurisht që do ta përmirësojmë edhe pse ne votojmë për procesverbalin, jo për transkriptin, megjithatë kërkoj që të bëhet korrigjimi.

Pasi nuk ka vërejtje tjera, konstatoj se Kuvendi miratoi procesverbalet e seancave plenare të datës 2, 3, 4, 5 dhe 11 qershor. Ju faleminderit!

Kalojmë në pikën e dytë të rendit të ditës.

- Koha për pyetje parlamentare

Deputetja Drita Kadriu, PDK, pyetje për ministren e Drejtësisë Nekibe Kelmendin. Zonja deputete e keni fjalën. Mund t’ia parashtroni pyetjen.

DRITA KADRIU: Faleminderit, zoti Kryetar,
Zonja Ministre,

Unë po e përcjell përmes mediave dhe raporteve të Ministrisë suaj aktivitetin të cilin po e zhvillon për gjykatat e Mitrovicës dhe ato të Veriut, por megjithatë mendoj se pyetja ime është ende është aktuale.

Të drejtat e garantuara të qytetarëve të Kosovës siç janë: e drejta në qasjen në drejtësi, e drejta për të gjykuar brenda kohës së arsyeshme, e drejta për liri dhe e drejta për gjykatë të themeluara sipas ligjit në qytetin e Mitrovicës dhe gjykatat e veriut nuk respektohen.

Ministria e Drejtësisë së Serbisë më 22 shkurt të këtij viti ka aneksuar gjykatat komunale dhe ato për kundërvajtje në Leposaviq dhe Zubin Potok dhe stafi i këtyre gjykatave të quajtura të UNMIK-ut, iu bashku stafit të gjykatave paralele. Këto çështje janë ngritur edhe në raportin e OSBE-së për muajin mars rreth monitorimit të sistemit juridik.

KRYETARI: Ju lus, e shfrytëzoni kohën për pyetje.
Zonja Ministre e ke fjalën.

MINISTRJA NEKIBE KELMENDI: I nderuar Kryetar i Kuvendit,
I nderuari zëvendëskryeministër,
Të nderuar kolegë ministra,
Të nderuar kolegë deputetë,
E nderuara deputete Drita Kadriu,

Nëse e keni fjalën për pyetjet që më janë adresuar më 13 maj 2008 -a është ajo pyetja, unë do të përgjigjem, këtu nuk është një pyetje, por janë katër pyetje. Pra, do të përgjigjem në secilën prej tyre veç e veç.

Të drejtën për qasje në drejtësi, kjo e drejtë është e garantuar edhe me Kodin e Procedurës Penale, edhe me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, edhe me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe unë nuk kam çka t'i shtojë, por më vjen mirë që keni njohuri nga fusha e të drejtave të njeriut.

Sa i përket të drejtës për gjykim brenda kohës së arsyeshme edhe kjo është pjesë e Konventës Evropiane. Për fat të keq Ministria e Drejtësisë nuk i menaxhon gjykatat. Megjithatë Ministria e Drejtësisë angazhohet që t'u krijojë kushtet teknike edhe kushtet tjera gjykatave që të punojnë në mënyrë të efektshme dhe të jenë funksionale.

Edhe unë kam shqetësim për mos gjykimin brenda afatit të arsyeshëm siç është paraparë me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut kjo po ndodh për fat të keq, sepse në gjykatat kosovare është zvogëluar numri i gjyqtarëve, kurse numri i lëndëve është rritur shumë. Nga ana tjetër gjyqtarët dhe prokurorët ndërkombëtarë janë të pakët dhe ato procedura zhvillohen me vështirësi të mëdha, sepse bëhen me përkthime. Çdo shkresë, çdo aktgjykim, çdo akuzë, çdo ankesë e tjera përkthehen, kështu që nuk po mund të respektohet me saktësi ai parimi i artë për gjykim brenda afatit sa më të shkurtër. Megjithatë, janë çështje të Këshillit Gjyqësor dhe e Departamentit të Drejtësisë që të merren me këto çështje, kurse unë letrat që më janë drejtuar përkitazi me gjykim të shpejtë i jam drejtuar Departamentit të Drejtësisë dhe ai ka ndërmarrë disa masa dhe është duke ndërmarrë disa veprime për ta mënjeluar këtë shkelje të drejtave të njeriut.

Të drejtën për liri nuk e di unë si të përgjigjem lidhur me këtë. Nëse e keni fjalën për të paraburgosurit ato janë procedurat dhe vetëm në bazë të vendimit të gjykatës dikush mund të mbahet në paraburgim ose mund të lirohet ...

KRYETARI: Faleminderit!

Ju përkujtoj se koha për pyetje është një minutë, për përgjigje tre minuta. Për pyetje shtesë përsëri është një minutë, për përgjigje 2 minuta.

Deputete, a do të bësh pyetje shtesë? Urdhëro!

DRITA KADRIU: Çështjet që ju i theksuat unë i kam përmendur si referencë, ndërsa pyetja ime është – Cilat janë aktivitetet e Ministrisë së Drejtësisë për t'i ofruar shërbime qytetarëve, shërbimet e gjykatave të qytetarëve të Mitrovicës dhe për të marrë në kontroll lëndët dhe sistemin në gjykatat e Leposaviqit dhe Zubin Potokut? Faleminderit!

KRYETARI: Ministre e ke fjalën! 2 minuta i ke kohë.

MINISTRJA NEKIBE KELMENDI: Si Ministri e Drejtësisë kemi kontaktuar me të gjitha institucionet relevante kombëtare dhe ndërkombëtare. Kam kërkuar edhe që të angazhohet edhe UNMIK-u më tepër, sepse është përgjegjësi e tij që t'u krijojë kushtet dhe të sigurojë: gjyqtarë, prokurorë, stafin administrativ dhe palët që të funksionalizohen gjykatat në veri të Mitrovicës, mirëpo, nuk po tregojnë vullnet. Unë këtë e them me përgjegjësi të plotë morale dhe materiale, gjë që nuk do të duhej të ndodhte, sepse u

është thënë vetëm për 10 ditë sa qetësohet situata, u bënë 4 muaj dhe ata nuk po mund të kthehen e të punojnë në gjykatat e tyre të ndërtuara me djersën tonë...

KRYETARI: Faleminderit!

Deputeti Naim Rustemi, Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës, pyetje për ministren e Drejtësisë, zonjën Nekibe Kelmendi. Naimi mungon.

Përsëri është pyetja e tretë, deputeti Naim Rustemi, por ai mungon. Do të thotë tjera nuk kemi. Nëse doni t'i lexoni pyetjet mund të vazhdojmë.

Deputetja Suzan Novobrdaliu, AKR, pyetje për Kryeministrin e Kosovës, zotin Hashim Thaçi. Doni ta bëni pyetjen deputete? Urdhëro e keni fjalën!

SUZAN NOVOBRDALIU: Faleminderit, zoti Kryetar!

Përsëritje për të gjithë,

Pas luftës në Kosovë, fatkeqësisht, është rritur numri i vetëvrasjeve, duke i përfshirë këtu edhe të rinjtë. Pyetja ime është - A ka ndonjë program Qeveria se si ta parandalojë këtë dukuri që po i shkakton shumë dhimbje Kosovës, si dhe a i ka hulumtuar Qeveria shkaqet e vetëvrasjeve? Pra, a janë: vështirësitë ekonomike, traumat e pasluftës, apo arsyt tjera personale?

KRYETARI: Faleminderit! Pyetja tjetër, po ashtu, deputetja Suzan Novobrdaliu, AKR, pyetje për Kryeministrin e Republikës së Kosovës, zotin Hashim Thaçi. Urdhëroni, deputete e keni fjalën!

SUZAN NOVOBRDALIU: Faleminderit, zoti Kryetar!

Kjo pyetje i është adresuar ministres së Drejtësisë, sa e di unë prej seancës së kaluar. A mund ta parashtroj?

Jemi dëshmitarë të përqindjes së madhe të papunëve në Kosovë, duke i përfshirë edhe qytetarët e moshës mbi 45 deri në 65 vjet. Në këtë kategori janë, zakonisht, personat që më herët kanë punuar dhe kanë mbetur pa punë për shkak të privatizimit të ndërmarrjeve të tyre ose kanë qenë të përjashtuar nga puna gjatë viteve 90 e të cilët më vonë pas 10 vjetëve për shkak të moshës nuk kanë mundur të punësohen më. Tani ata janë pa të ardhura, pa ndihma, në një ose mënyrë tjetër nuk mund të rikualifikohen kështu që mundësia e punësimit të tyre është shumë e vogël. A ka ndonjë program të veçantë Qeveria e Kosovës për këtë kategori të qytetarëve?

KRYETARI: Kjo pyetje absolutisht nuk është për ministren zonjën Nekibe Kelmendi, por për Kryeministrin. Mund të jetë edhe për ministrin e Punës dhe Mirëqenies Sociale. Pra, pyetja i është adresuar Kryeministrit të Kosovës, zotin Hashim Thaçi, me datë 14.05.2008, numri i lëndës 302.

Urdhëro, deputete!

SUZAN NOVOBRDALIU: Ministri këtë pyetje time, në të vërtetë, ia ka adresuar zonjës Nekibe. Mund ta shihni edhe në procesverbal të seancës së kaluar, kur kanë qenë pyetjet parlamentare. Meqë zonja Nekibe nuk ka qenë këtu, atëherë unë ruaj të drejtën që në seancën e radhës t'ia paraqes Kryeministrit këtë pyetje.

KRYETARI: Kërkesa me shkrim është për Kryeministrin. Ne e kemi kërkesën, që ku është kërkesa. Faleminderit!

Vazhdojmë me pyetjen tjetër.

Deputeti Driton Tali, ka parashtruar pyetje për Kryeministrin, zëvendëskryeministrin apo ministrin e Transportit dhe Postë Telekomunikacionit, zotin Fatmir Limaj. Urdhëro, deputet, bëje pyetjen. Koha një minutë

DRITON TALI: Pyetja është teknike, nuk di zëvendëskryeministri a do të mund të përgjigjej, andaj do ta shtyj për seancën e ardhshme, zoti Kryetar. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Deputetja Drita Maliqi, LDD, pyetje për Kryeministrin e Republikës së Kosovës, zotin Hashim Thaçi. A doni ta bëni pyetjen deputete? Fjalën e ka deputetja Drita Maliqi!

DRITA MALIQI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Meqë Kryeministri nuk është prezent, kisha lutur nëse ka mundësi zoti ministër i Shërbimeve Publike të më përgjigjet. E kisha parashtruar pyetjen, sepse është me të vërtetë shumë e rëndësishme sa i përket komunës prej nga vij.

I nderuari zoti ministër. Vazhdimisht në deklaratat tuaja, domethënë, po flas në përgjithësi në kuadër të Qeverisë, keni deklaruar se do të qeverisni mirë dhe do të respektoni ligjet në fuqi dhe ne nuk do të bëni spastrime në shërbyesit civil. Mirëpo, në praktikë po ndodh e kundërta siç është rasti në Kuvendin Komunal të Gjilanit. Kryetari i Kuvendit Komunal të Gjilanit që vjen nga partia juaj është duke suspenduar dhe mënjeluar njerëz nga pozicionet e shërbimit civil dhe është duke degraduar njerëz pa kritere dhe emëron militantë partiak të Partisë Demokratike të Kosovës, pa respektuar institucionet e konkursit. Të gjitha këto veprime bien ndesh me Rregulloren 2001....

KRYETARI: Pyetja një minutë. Zoti ministër, a doni të përgjigjeni? E keni fjalën.

MINISTRI ARSIM BAJRAMI: Faleminderit, deputetes për këtë pyetje.

Edhe pse nuk e pritja këtë pyetje, sepse siç tha deputetja iu ka adresuar Kryeministrit, mua nuk më ka ardhur kjo pyetje me shkrim, por megjithatë do të përgjigjem.

Ne mund të përgjigjem për nivelin republikan të shërbimit civil, ndërkaq për funksionimin e pushtetit lokal do të duhej edhe ministri i Pushtetit Lokal të involvohet në këtë pyetje. Sa i përket nivelit Republikan të shërbyesve civilë që po punojnë në institucionet Republikane mund të them që Qeveria është jashtëzakonisht e kujdesshme ndaj shërbimit civil. Me qenë se pranë Ministrisë së Shërbimeve Publike funksionon Departamenti i Shërbimit Civil ne edhe monitorojmë shërbimin civil dhe mund të them me plotë përgjegjësi se nuk kemi marrë ende asnjë ankesë formale të ndonjë shërbyesi civil, i cili do të ankohej në trajtimin e tij ligjor pas ndërrimit qeveritar dhe Qeveria e ka një kujdes të veçantë ndaj shërbimit civil. Kjo qeveri po punon në mënyrë intensive që të krijojë një kulturë ndaj shërbimit civil, një kulturë shtetërore që shërbimi civil është një shërbim shtetëror i cili nuk do të ndikohet ndaj zhvillimeve politike dhe mund të them që ne nuk dëshirojmë t'i ripërsërisim praktikat që kanë qenë në të kaluarën ku jo rrallë shërbimi civil është atakur me ndërrime politike, sepse jemi duke punuar edhe me

partnerët tanë ndërkombëtarë që të ndërtojmë një shërbim civil shumë neutral, i cili do të jetë më tepër një servis publik i qytetarëve se sa një segment i pushtetit. Në këtë drejtim ne kemi një strategji, jemi duke hartuar një strategji dhe së shpejti këtij Kuvendi do t'i propozohet edhe Ligji për shërbimin civil që po hartohet me partner ndërkombëtar, i cili, vërtet, do të krijojë civilë shtetëror në shërbim të shtetit jo në shërbim të partive politike. Ne e kemi këtë version dhe do ta implementojmë.

Megjithatë, rastin që ju e theksuat këtu ne do ta hetojmë, do të koordinojmë me ministrin e Pushtetit Lokal, do t'i kontaktojmë edhe autoritetet lokale dhe në një mbledhje të ardhshme ne do të mund të japim një informatë të kualifikuar për rastin konkret që ju keni ngritur. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, ministër!

Pyetja e radhës nga deputetja Qamile Morina, LDD, Pyetje për ministrin e Shëndetësisë, zotin Alush Gashi, i cili nuk është këtu. A doni ta bëni pyetjen. Fjala për Qamile Morinën. Unë po pres. fjalën e keni ju, Regjia.

QAMILE MORINA: Unë nuk besoj që do të mund dikush të përgjigjet lidhur me pyetjen për sektorin e shëndetësisë, kështu që do ta lë për seancën kur ministri i Shëndetësisë do të jetë i pranishëm. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Pyetja e radhës është e deputetit Driton Tali, për Kryeministrin zotin Hashim Thaçi. A doni ta parashtroni pyetjen deputet?

DRITON TALI: Po, zoti Kryetar, por nuk di çfarë kompetencash ka zoti zëvendëskryeministër, a mund të kërkojë dorëheqje nga ministrat e tij? Pyetja është për një dorëheqje të ministrit të Ekonomisë dhe Financave për shkak të implikimeve të tij në shitjen e Feronikelit. Andaj, do të ishte e udhës që t'ia bëjë këtë pyetje zotit Kryeministër si shef i Kabinetit. Megjithatë, po më duket se këtë seancë, zoti Kryetar e kemi huqur, jemi tubuar për kurrfarë arsyeje.

KRYETARI: Faleminderit! Ju e dini se kur dhe si është shitur Feronikeli, edhe unë e di shumë mirë, prandaj mendoj që duhet të adresoni atje ku duhet.

Vazhdojmë, deputetja Luljeta Shehu, LDK, pyetje për ministrin e Energjisë dhe të Minierave, zonjën Justina Pula, nuk është. Deputete, a doni ta bëni pyetjen? Fjala për Luljeta Shehun.

LULJETA SHEHU: Do ta bëj sepse në shtëpi s'ka qenë ajo. Arsyeja për pyetje është, sepse familjet e të pagjeturve, të dëshmorëve dhe familjet me asistencë sociale për shkak të pensioneve të ulëta që i kanë pasur, shumë e borxhit për rrymë elektrike prej pas luftës nuk kanë pasur mjete financiare për ta paguar. Prandaj, pyetja është- Çfarë është mundësia e shlyerjes së borxhit të rrymës për familjet e të pagjeturve të dëshmorëve dhe me çështje sociale prej vitit 1999 deri më 2007, me qëllim që prej 2008 të fillohet të bëhet pagesa e rregullt e rrymës për familjet e përmendura? Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Përsëri Luljeta Shehu ka pyetje për ministrin e Arsimit, Shkencës dhe Teknologji, zotin Enver Hoxhaj. Deputete, mund ta bëni pyetjen!

LULJETA SHEHU: Do t'ia bëjë kur të jetë ministri.

KRYETARI: Faleminderit!

Pyetja e radhës, deputetja Rita Hajzeraj ka pyetje për ministrin e Shëndetësisë, zotin Alush Gashin. Deputete, mund ta bëni pyetjen.

RITA HAJZERAJ: Faleminderit, zoti Kryetar!

Po më vjen keq që po shihet qartë papërgjegjësia e shumicës së ministrave këtu dhe nuk janë prezentë në shumicën e rasteve. Pyetja ime i dedikohet ministrit të Shëndetësisë, pasi që ai nuk është këtu, unë e kaloj pyetjen time në seancën e ardhshme. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Ju e dini cila ishte kërkesa, ju votuat që të mos të hiqet. Vazhdojmë, deputetja Gjylnaze Syla, AAK, pyetje për ministrin e Tregtisë dhe të Industrisë, zotin Lutfi Zharku. Deputete, e keni fjalën.

GJYLNAZE SYLA: Faleminderit, zoti Kryetar!

Seanca e sotme tregoi sa e papërgatitur është dhe se nuk po mund që ta ushtroj funksionin mbikëqyrës, zoti Kryetar, dhe ju e keni përgjegjësinë për t'u kujdesur për këtë. E dini që pyetjet parlamentare janë instrument mbikëqyrjes, Prandaj pyetjet e mia do t'ia adresoj Kryeministrit kur të jetë këtu me shpresën se do të vjen në ndonjë seancë dhe t'iu përgjigjet pyetjeve. Faleminderit!

KRYETARI: Është mirë të kursehem nga disa fjalë.

Pyetja e radhës, deputetja Gjylnaze Syla, pyetje për Kryeministrin Hashim Thaçi. A doni fjalën? Regjia - fjalën deputetes Gjylnaze Syla.

GJYLNAZE SYLA: Zoti Kryetar, u thirra në përgjegjësinë tuaj, e keni përgjegjësinë për mbarëvajtjen e seancës. Edhe dy pyetjet tjera për të mos shkuar, meqenëse i kam edhe një pyetje për ministrin e Industrisë dhe Tregtisë, preferoj që kur të jenë ministrat t'iu përgjigjen pyetjeve. Faleminderit!

KRYETARI: Po, kujtoj se unë e udhëheq seancën me njerëz që janë këtu, s'jam xhandar të sjell me zor në seanca askënd.

Pyetja e tretë e rendit të ditës është:

- Shqyrtimi i parë i Projektligjit për armët

Në bazë të Rregullës 35.1 të Rregullores së Punës së Kuvendit, janë përmbushur kushtet për shqyrtim dhe miratim në parim të këtij projektligji, Projektligji u është shpërndarë deputetëve më 28 maj 2008.

Ftoj ministrin e Punëve të Brendshme zotin Zenun Pajaziti që në emër të Qeverisë, para deputetëve të Kuvendit, të prezantoj Projektligjin.

MINISTRI ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Zoti zëvendëskryeministër, ministra,

Të nderuar deputetë,

Më lejoni të prezantoj Projektligjin për armët, të propozuar nga Ministria e Punëve të Brendshme. Po ashtu, në fillim më lejoni t'i falënderoj të gjithë përfaqësuesit misionëve ndërkombëtare, organizata joqeveritare dhe të tjerë që na kanë ndihmuar në përgatitjen e këtij projektligji.

Duke e mbështetur në rëndësinë dhe peshën që ka ky ligj për Kosovës dhe qytetarët e saj, shihet qartë se bëhet fjalë për projektligj me prioritet të lartë për Qeverinë dhe Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Fushëveprimi i këtij projektligji është rregullimi i kushteve për: shitblerjen posedimin, mbajtjen rruajtjen, prodhimin, riparimin, paaftësimin, qarkullimin, ndërmjetësimin, transportin dhe bartjen e armëve brenda territorit të Kosovës, si dhe eksportin, importin dhe transitin për persona fizik dhe juridik.

Nevoja për këtë projektligj është e madhe për faktin se në Kosovë ekziston një numër mjaftë i madh i armëve ilegale.

Projektligji ka për qëllim t'i adresojë të gjitha çështjet të cilat, siç i thashë më lart, kanë të bëjmë me: shitblerjen, posedimin, mbajtjen, ruajtjen, riparimin, paaftësimin, bartjen e armëve brenda territorit të Kosovës etj..

Projektligji ka 13 kapituj me gjithsejtë 86 nene. Projektligji krijon një stabilitet legjislativ për veprimtarinë të cilën e rregullon.

Interesim për këtë projektligj ka shprehur organizatat ndërkombëtare që veprojnë në Kosovë, të cilat përmes përfaqësuesve të tyre kanë dhënë disa rekomandime, të cilat, po ashtu, janë inkorporuar në këtë projektligj.

Projektligji për armët ka implikime buxhetore që vlerësohen të jenë përafërsisht prej 1 milion e 638 mijë e 810 euro. Sipas viteve kjo paraqitet kështu. Në vitin 2008 vlerësohet se nuk do të ketë kosto shtesë, në vitin 2009, 984 mijë euro, në vitin 2010 kostoja shtesë buxhetore do të jetë 654 mijë euro. Bartës kryesor të koston shtesë buxhetore paraqiten: krijimi dhe funksionimi i organit kompetent, pra është një njësi brenda Ministrisë së Punëve të Brendshme që planifikohet të ketë një drejtor dhe 4 zyrtarë. Pastaj, një pako e sistemit ibis që shërben për identifikimin e gëzhgojave dhe plumbave, në një sistem integruar i identifikimeve balistike si dhe një sobver për të dhënat e armës.

Ndërsa të hyrat vetanake të gjitha mjetet e realizuara në bazë të këtij projektligji derdhen në buxhetin e konsoliduar të Kosovës. Të hyrat nga licenca e të tjera planifikohen të realizohen në 1.800.000 euro, normalisht jo për një vit dhe totali i të hyrave që priten të realizohen për periudhën e vlerësimit të ndikimit buxhetor 2008 – 2010 është 1.900.000 euro.

Projektligji ka deklaratën e pajtueshmërisë të Agjencisë për Integritet Evropian që nënkupton që është në pajtim me legjislacionin e BE-së.

Nga këto arsye propozoj që Kuvendi i Republikës së Kosovës ta miratojë në parim Projektligjin për armët dhe ta procedojë në procedurë të mëtejme. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Sipas radhës deputeti, nga Partia Demokratike, zoti Rustem Mustafa.

RRUSTEM MUSTAFA: Faleminderit, zoti Kryetar!

Projektligji ka ardhur në Grupin Parlamentar dhe mund të them që në grup parlamentar jemi dakorduar që ta procedojmë më tutje. Edhe në Komision, gjithashtu, kemi punuar dhe kemi caktuar referuesin për këtë projektligj- zotin Shkumbin Demaliaj. Ne kësaj radhe do ta falënderojmë sponsorin, ministrin e Punëve të Brendshme se vërtet e ka sjellë një ligj me bazë të mirë për të ecur më tutje. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Atëherë, ia kalojmë fjalën deputeti Shumbin Demaliaj.

SHUMBIN DEMALIAJ: Faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,
Ministra, zoti zëvendëskryeministër,

Lidhur me Projektligjin për armët e tha edhe vet kryetari i Komisionit për Siguri, por edhe ne si Grup Parlamentar e kemi shqyrtuar Projektligjin, sepse është një prej projektligjeve që ka ardhur me kohë në sirtarët e Kuvendit.

Projektligji është një prej projektligjeve të hartuara me vëmendje të posaçme. E falënderojmë Ministrinë lidhur me këtë, sepse ka marrë të gjitha përvojat e rajonit dhe i ka inkorporuar në këtë projektligj.

Kemi disa vërejtje lidhur me afatet kohore për shkak se aplikantët i nënshtrohen disa testeve fillimisht për manipulimin edhe njohurinë që kanë mbi armët, por është një afat kohor shumë i shkurtër që i përgjigjet poseduesit ata që do të marrin lejen për armët. Besojmë se edhe të gjitha vërejtjet të tjera që lindin në kapitujt e ndryshëm gjatë tërë projektligjit janë të mundshme, sepse ka disa gabime teknike profesioniste ku personat juridikë që do të merren me prodhimin e armëve dhe mundësitë tjera që paraqiten. Kur flitet edhe për shtetasit e huaj thotë- shtetasit e huaj jo kompanitë e huaja, sepse nuk mundet një shtetasi i huaj për të fituar licencë aq të madhe, por me rëndësi është se është edhe një inkorporim edhe bashkëpunim i mirë mes Ministrisë së Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme, brenda këtij projektligji. mirëpo edhe hapësirë më të madhe i kanë dhënë që është e drejtë dhe është shumë e mirë që mundësitë e ardhshme të zhvillohen brenda këtij ligji, duke i lënë mundësi shumë që të nxjerrën edhe akte të shumta nënligjore që rregullojnë shumë mirë rregullativa dhe mundësinë e implementimit sa më të mirë të këtij projektligji.

Edhe një herë në emër të grupit parlamentar dhe të Komisionit për Siguri dhe Punë të Brendshme e përkrahim këtë projektligj edhe besojmë në kohën e caktuar do të japim edhe amendamentet që do t'i bashkangjesim këtij projektligji dhe ligji do ta marrë formën e tij dhe të jetë plotësisht i implementueshëm. Në kuadër të kësaj do të bashkëpunojmë edhe me organizatat tjera, e sidomos me Shoqatën e Gjuetarëve dhe të Shenjëtarisë që fund e krye përmendet nëpër të gjithë kapitujt dhe nenet e Projektligjit, pra do të organizojmë edhe një dëgjim publik për këtë çështje, kështu që edhe ligji do të ecën më tutje.

Ne jemi për dhe e përkrahim. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Fjalën e ka deputeti Fatmir Rexhepi, në emër të Lidhjes Demokratike të Kosovës.

FATMIR REXHEPI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Përsëritet kolegjë deputetë, Kabinet qeveritar,

Po ashtu, Grupi Parlamentar i LDK-së në debatin e tij ka vlerësuar dhe i jep përkrahjen, në parim, këtij projektligj dhe mendon që në komisionet përkatëse të japë kontributin e mëtutjeshëm. Bazuar në ato fakte që u thanë, në Kosovë ka shumë armë ilegale dhe ky projektligj këtu e ka rëndësinë e tij jo vetëm për shkak të procedimit sot, por edhe të një hartimi të mirë që është bërë nga Ministria e Punëve të Brendshme. Vendosija e të gjitha kodeve ligjore lidhur me posedimin e armëve dhe gjithë asaj materie që përfshihet në këtë projektligj, do të ndihmojë shumë dhe do të jetë me interes të veçantë, pra në sundimin e ligjit nëse implementohet tutje ky për krijimin e sigurisë më të madhe për gjithë qytetarët. Këtu e shohim, pra rëndësinë e tij bashkë me atë që do të thotë përcakton saktë: fushëveprimin, organet kompetente, si dhe të gjitha rregullat lidhur me armët deri te ato ...

KRYETARI: Faleminderit!

Fjalën e ka deputeti Naim Maloku.

NAIM MALOKU: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Para nesh është një ligj i cili është punuar gjatë. Është një ligj tejet i nevojshëm për Kosovën. Duke marrë parasysh rrethanat dhe situatën që ka kaluar shoqëria kosovare dhe shteti i Kosovës. Është ligji i cili do të vë rend në përdorimin mbajtjen, prodhimin e armëve të vogla. Kosova, sipas hulumtimeve dhe analizave që i kanë bërë organizatat joqeveritare dhe ekspertë tjerë jashtë institucional, është mjaft e ngarkuar me numër tejet të madh me armëve të vogla në posedim të qytetarëve të Kosovës që kjo sasi dhe ky numër i armëve të vogla jashtë kontrollit janë rrezik potencial edhe për sigurinë e qytetarëve të Kosovës dhe Kosovës në përgjithësi.

Edhe unë e falënderoj, pra NDP dhe të gjitha organizatat tjera të cilat janë kyçur në këtë proces të hartimit dhe përgatitjes të këtij projektligji.

Më lejoni që të ndalem në kapitullin 5 të Projektligjit, që ka të bëjë me prodhimin e armëve. Kosova ka një traditë edhe nga e kaluara, pavarësisht që kapacitetet prodhuese të industrisë së armatimit kanë ndërruar dedikimin pas privatizimit dhe janë shkatërruar, por ka mbetur kuadri profesional dhe ky kuadër e bën Kosovë joshëse për t'i hyrë prodhimit ose për të qenë pjesë ose për të qenë interesante Kosova për investitorë të jashtëm të kësaj të kësaj fushe, të kësaj industrie.

Neni 45, paragrafi 2 nën 2 i -thotë: "Licenca për prodhim të armës- municionit dhe riparimet e armës i jepet personit juridik dhe pastaj 2 i - thotë: "është shtetas i Republikës

së Kosovës” dhe 3 i është: “Shtetasi i huaj që në momentin e paraqitjes së kërkesës ka vendqëndrim në Kosovë”. Mendoj që kjo duhet të riformulohet ky nen, kemi të bëjmë me person juridikë pra, kem të bëjmë për kompani, për firma dhe jo për qytetarë dhe kjo duhet të ndryshohet dhe mendoj se gjatë shqyrtimit të këtij projektligji ne do të japim kontributin tonë si grup parlamentar që ky nen të riformulohet.

Zoti ministër, ju keni bërë shumë mirë kur e shpjeguat se ligjet që po na vijnë në Kuvend po thuhet kostoja financiare, por nuk po prezantohen para deputetëve të hyrat që do të krijohen për buxhetin e Kosovës me implementimin e këtij projektligji. Siç e keni parë, ministri e sqaroi mirë se të hyrat nga licencat, qoftë leje për mbajtjen e armëve për lejet ose licencat për tregti me armë, për repartet e riparimit të armëve ose të prodhimit, pra, janë të hyra më të larta se sa shpenzimet buxhetore ose kostoja buxhetore e këtij projektligji, Unë e ftoj Kuvendin e Kosovës që ta miratojë në parim këtë projektligj. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zoti deputet.

Radhën e ka shefi i Grupit Parlamentar të LDD-së, deputeti Lulzim Zeneli.

LULZIM ZENELI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Në parim, Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Dardanisë e mbështet këtë Projektligj, duke e cilësuar si një nga ligjet që po procedohen në këtë Kuvend, dhe ka rëndësi shumë të madhe, jo për vetë faktin se përmban strukturën e qëlluar apo është i ndërtuar mbi atë bazë që garanton një funksionalitet, sa për faktin se Kosova është vend që e ka përjetuar periudhën e luftës dhe numri i armëve apo qarkullimi i tyre tek qytetarët e Kosovës zënë përmasa, sipas të gjitha statistikave që janë adresuar deri më tash, përmasa shqetësuese.

Prandaj, duke e përkrahur këtë Projektligj, sepse është një prej projektligjeve që në mënyrë shumë të qartë dhe kompetente adreson përgjegjësitë dhe krijon obligime tek autoritetet kompetente dhe krijon një bazament të fuqishëm në respektimin e normave për të cilën qytetarët e Kosovës dhe Kosova ka më shumë nevojë se kurrë, prandaj në parim ne e mbështesim dhe si Grup parlamentar përmes anëtarëve tonë do ta japim kontributin tonë në komisionet parlamentare. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit, zoti deputet!

Para se t’ia jap fjalën shefit të Grupit Parlamentar “7+”, kërkoj nga deputetët që janë këtu pari le të kthehen në sallë për t’u përgatitur për votim. Fjalën e ka deputeti Zylfi Merxha.

ZYLFI MERXHA: Ju faleminderit, zoti Kryetar i Republikës së Kosovës!

Ju përshëndes juve dhe stafin e juaj, po ashtu zëvendësin e Kryeministrit, ministrat,

Na e dëgjuam ministrin e Punëve të Brendshme që na referoi për një ligj, të cilin kosovarët me shpirt e kanë pritur, se të gjithë i kanë hazër armët, por nuk i kanë lejet. Edhe Komisioni ynë e ka vlerësuar se ky Ligj, deri më tani është ligji më i mirë që është përgatitur. Për këtë arsye, edhe Grupi Parlamentar “7+” jemi për atë që sa më shpejt të nxirret ky Ligj. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Sipas radhës, Grupi Parlamentar i SLS-së e ka fjalën. Nuk është paraqitur askush për fjalë.

A e do dikush fjalën? Fjalën e ka kërkuar deputeti Riza Smaka.

RIZA SMAKA: I nderuari Kryetar,

Të nderuar qeveritar dhe deputetë të respektuar,

Disa vërejtje parimore me qëllim që deri në etapën e dytë të eliminohen. Ligji për armët, tani për tani projekt, do të duhej të kishte përmbajtjen e dispozitave: Një, do duhej të ishte në njëjës. Nuk mund të thuhet “leja i jepet shtetasve”, se atëherë shtetasi nuk do të kishte të drejtë kurrë për ta marrë lejen, po e zëmë. Do të duhej të ishte i harmonizuar në të tri gjuhët, ka shumë diskrepanca që do të reflektoheshin me probleme në aplikim.

Ju lutem, neni 6, paragrafi 5, jep mundësi që personit fizik t’i mundësohet për t’i blerë, po e zëmë, së paku 200 fishekë për armë me tytë me vjaska. Kjo është diçka tepër, është nonsens, sikur donte për të hapur front, e qëllimi është që të ketë armë, nëse do të huhej të kishte armë dhe, bie fjala, 20 fishekë, 30 fishekë do të ishte optimumi.

Ju lutem, te neni 11, paragrafi 1, bile thotë “ii” që nuk është teknikë e pranueshme në juridikë. “Konsiderohet se ekziston rrezik për rendin publik nëse personi fizik është dënuar për vepër penale të prishjes së qetësisë publike”. Nuk ka vepër penale e cila nuk e prishë qetësinë publike. Qetësia publike priset me kundërvajtje, prandaj kjo duhet të riformulohet, si të them, ky diksion, se është qesharak.

Në nenin 58, medoemos do të duhej të inkorporoheshin specifikat dhe postulatet e standardeve teknike për Poligonin civil për qitje, në mënyrë që mos të ndodhte ngjashëm me Gërdecin, sepse pritet se bizneset do të bënin shumë oferta dhe shumëkush do të merrte licenca.

Në nenin 74 është një formulim i cili nuk mund të qëndrojë, ku thuhet: “Për veprat penale dënohet personi fizik i cili...”, i cili, po e zëmë, ju lutem, me këtë ligj nuk mund të caktohen veprat penale. Përgjegjësia penale, veprat penale caktohen me Kodin penal e jo me ligj, jo me këtë ligj. Dhe, përfundimisht, një vërejtje serioze dhe sugjerim. Mendoj se është i nevojshëm, raciolegisti i këtij ligji do të duhej të konsistonte në mbledhjen e armëve, aq sa është e mundur, në dhënien e lejeve vetëm në rastet e bazuara në ligj dhe në mbikëqyrjen e tyre. Kjo politikë do të duhej të sublimohej në dispozitë dhe në kaptinë të veçantë. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit, deputet!

Deputetë të tjerë nuk janë lajmëruar për diskutim. Atëherë, ne duhet të deklarohejmë. Në sallë janë 76 deputetë. Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim. Votojmë tash:

Sa deputetë janë pa kartela? Ju faleminderit!

“Për” janë 75 deputetë, 1 ka abstenuar. Konstatoj se Kuvendi miratoi në parim Projektligjin për armët.

Në bazë të rregullave 23.7 dhe 35.4 të Rregullores së Punës së Kuvendit, Kuvendi ngarkon këto komisione:

1. Komisionin për Punë të Brendshme dhe Siguri, si komision funksion

- funksional dhe raportues.
2. Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi,
 3. Komisionin për Buxhet dhe Financa,
 4. Komisionin për Komunitete, dhe
 5. Komisionin për Integritet Evropian.

Komisioni duhet që brenda 2 muajve, nga shqyrtimi i parë, Kuvendit t'i paraqesin Raportin me rekomandime.

Pikën e katërt e kemi hequr nga rendi i ditës. Gjithashtu e kemi hequr nga rendi i ditës edhe pikën e pestë dhe tani jemi në pikën e gjashtë të rendit të ditës:

- Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për përfitimet e ish zyrtarëve të lartë

Miratimi në parim i Projektligjit është bërë me 26 shkurt 2008. Shqyrtimi i dytë i këtij projektligji ka qenë në rend të ditës në Seancën e datës 29 prill 2008, por me kërkesën e Grupit Parlamentar të PDK-së është hequr nga rendi i ditës me qëllim të harmonizimit të qëndrimeve në mes të Komisionit për Buxhet dhe Komisionit për Legjislacion.

Ndërkohë, Komisioni për Legjislacion si komisioni funksional edhe raportues dhe Komisioni për Buxhet dhe Financa, kanë rishqyrtuar raportin me rekomandimet e datës 1 prill 2008, ua shpërndarë deputetëve me 24. prill 2008, dhe kanë rekomanduar miratimin e tij.

Rekomandimi i komisioneve iu është shpërndarë deputetëve. Komisionet parlamentare kanë shqyrtuar Projektligjin dhe Kuvendit ia kanë paraqitur raportin me rekomandime.

Para se ta procedojmë me votimin e amendamenteve të propozuara, ftoj kryetarin dhe raportuesin e komisionit funksional, nëse e shih të nevojshme për ta arsyetuar raportin me rekomandime. Fjalën e ka deputeti Bahri Hyseni.

BAHRI HYSENI: Ju faleminderit, zoti Kryetar!
Përsëritet zëvendëskryeministër,
Ministra të nderuar,
Kolegë deputetë,

Natyrisht, pas tërheqjes nga Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës, dy kryetarët e komisioneve, ai për Buxhet dhe Financa dhe kryetari i Komisionit për Legjislacion, kanë formuar dy nënkomisione të cilat edhe njëherë e kanë shqyrtuar projektligjin në fjalë, dhe pasi që kemi shqyrtuar veç e veç të gjitha amendamentet, të dy komisionet janë pajtuar që Kuvendit të Kosovës t'i paraqesin Projektligjin me rekomandimet, si më poshtë:

Jemi pajtuar që të miratohet në Kuvendin e Republikës së Kosovës Projektligji me amendamentet e propozuara dhe kemi kërkuar që në një të ardhme të afërt që shikohet mundësia, pas plotësimit me infrastrukturë ligjore për funksionet e larta, si do të ndodhë për themelimin e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, Ligjin për Prokurim publik të Kosovës, të shikohet mundësia se në të ardhmen e afërt a do të ketë mundësi që edhe

ish zyrtarët e tjerë të lartë të këtyre institucioneve të parashihen në këtë Ligj. Meqë aktualisht ish zyrtarët e lartë i përfitojnë të ardhurat e tyre në bazë të një rregulloreje të faktorit ndërkombëtar, është e domosdoshme që sot Kuvendi i Kosovës ta aprovojë Projektligjin me amendamentet e propozuara. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju njoftoj se gjatë shumëzimit të Raportit të Komisionit është përvjedhur faqja e tretë, kështu që raporti i kompletuar iu është shpërndarë edhe një herë, andaj kërkoj mirëkuptimin e juaj për këtë çështje.

Tani procedojmë me votimin e amendamenteve. Fillojmë votimin për amendamentin nr. 1.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash:

Tani kemi votimin me dorë për ata që nuk kanë kartelë. Ju lus, nga votimi me dorë i kemi 5 vota “për”.

A ka “kundër” nga votimi me dorë? Nuk ka. Atëherë, i kemi 70 vota “për”, “kundër” nuk ka, 7 abstenime. Konstatohet se miratohet amendamenti nr 1.

Amendamenti 2,

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash:

Sa janë “për” pa kartelë?

65 vota janë “për”, asnjë “kundër”, 6 abstenime. Miratohet amendamenti 2.

Amendamenti 3

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash:

Votimi “për”, për ata që nuk kanë kartelë. Do të thotë, 68 vota “për”, 1 “kundër”, 5 abstenime. Miratohet amendamenti nr. 3.

Amendamenti 4.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash:

Pa kartelë “për” janë 5vota. “Kundër” a ka pa kartelë? Nuk ka

Me 64 vota “për”, 1 “kundër”, 5 abstenime. Miratohet amendamenti nr. 4

Amendamenti 5

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash:

Votat e deputetëve pa kartela, “për” janë 5. Ju njoftoj se janë prezentë 79 deputetë.

Me 69 vota “për”, 2 “kundër”, 6 abstenime, miratohet amendamenti nr. 5.

Amendamenti 6

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash:

Votat e deputetëve pa kartela, “për” janë 5.

Me 65 vota “për”, 1 “kundër”, 5 abstenime, miratohet amendamenti nr. 6.

Amendamenti 7

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash:

Me 65 vota “për”, 1 “kundër”, 6 abstenime, miratohet amendamenti nr. 7.

AMENDAMENTI 8

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash:

Votat e deputetëve pa kartela, 5 “për”

Me 63 vota “për”, 1 “kundër”, 7 abstenime, miratohet amendamenti nr. 8

Amendamenti 9

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash:

Votat e deputetëve pa kartela, 4.

Me 68 vota “për”, 1 “kundër”, 9 abstenime, miratohet amendamenti nr. 9

Amendamenti 10

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash:

Votat e deputetëve pa kartela, 4.

Me 68 vota “për”, 1 “kundër”, 7 abstenime, miratohet amendamenti nr.10

Amendamenti i fundit, Amendamenti 11

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash:

Votat e deputetëve pa kartela, 5.

Do të thotë, me 67 vota “për”, 1 “kundër”, 6 abstenime, miratohet amendamenti 11.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votimin e tekstit të Projektligjit, në tërësi, me amendamentet e miratuara.

Votojmë tash:

Votat e deputetëve pa kartela, 5.

“Kundër” pa kartela, a ka? Nuk ka. Konstatohet se me 70 vota “për”, asnjë “kundër” dhe 6 abstenime, Kuvendi miratoi Ligjin për përfitimet e ish zyrtarëve të lartë.

Kalojmë në pikën e shtatë të rendit të ditës:

- **Kërkesa e ministrit për Ekonomi dhe Financa për ridestinimin e mjeteve për investimet kapitale nga projekti: “Kompleksi i ri qeveritar” për projektin: “Rinovimi i Pallatit të Mediave”**

Ministri i Ekonomisë dhe i Financave, në pajtim me Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë dhe Ligjin e buxhetit për vitin 2008, ka kërkuar ridestinimin e mjeteve për investime kapitale nga projekti: “Kompleksi i ri qeveritar” për projektin: “Rinovimi i Pallatit të Mediave”.

Komisioni për Buxhet dhe Financa ka shqyrtuar kërkesën e Ministrit për Ekonomi dhe Financa dhe ka rekomanduar miratimin e saj. Rekomandimi i Komisionit për Buxhet dhe Financa, së bashku me kërkesën e ministrit për Ekonomi dhe Financa iu është shpërndarë deputetëve.

Ftoj ministrin Arsim Bajrami që ta arsyetojë këtë kërkesë të Qeverisë.

ARSIM BAJRAMI: Ju faleminderit, Kryetar i Kuvendit!

In nderuari zëvendëskryeministër, ministra,

Të nderuar kolegë,

Në mungesë të ministrit të Financave, i cili zyrtarisht ndodhet jashtë vendit, do ta arsyetoj këtë kërkesë të Ministrisë së Financave për rialokimin e mjeteve apo ridestinimin e mjeteve nga pozicioni i Kompleksit qeveritar në pozicionin Renovimi i Pallatit të Mediave.

Dëshiroj t'ju rikujtoj se Qeveria e Kosovës ka miratuar planin rezidencial për akomodimin e institucioneve shtetërore nga objektet private në objekte publike dhe Ministria e Shërbimeve Publike ka bërë planin rezidencial dhe dinamikën e punimeve që gjatë këtij viti të realizohet kjo objektivë strategjike.

Ministria e Shërbimeve Publike do ta implementojë këtë plan në tri faza. Faza e parë ka filluar të implementohet dhe qysh në tetor do të kemi vendosjen e pesë ministrive nga shtëpitë private në objekte publike, kryesisht në objektet e ndërmarrjeve publike, të cilat pas hyrjes në fuqi të Kushtetutës së Republikës së Kosovës i ka marr nën administrim Qeveria e Republikës së Kosovës. Në fazën e dytë, mendohet që procesi të vazhdojë me renovimin e Pallatit të Mediave, ku është miratuar plani për vendosjen e 5 ministrive dhe 800 zyrtarëve. Njëkohësisht, në këtë fazë ne do të marrim në administrim edhe objektet e UNMIK-ut, objektet e tranzicionit. Jemi në përfundim të bisedave me autoritetet e UNMIK-ut, që ata në pajtim me pozicionin e ri dhe rikonfigurimin e ri që e kanë pësuar, të dorëzojnë një pjesë të objekteve dhe ato objekte të shfrytëzohen për nevojat e institucioneve të Republikës së Kosovës. Faza e tretë është ndërtimi i Kompleksit qeveritar, ndërtimi i një kampusi qeveritar, që është miratuar nga Qeveria e kaluar, dhe kjo fazë parasheh ndërtimin e 10 godinave reprezentative me standarde evropiane e cila parashihet të ndërtohet në një kompleks të ri, në Prishtinën e re, në lagjen Ajvalia.

Rreth këtij projektit të tretë, Ministria e Shërbimeve Publike ka filluar menjëherë përgatitjet dhe ideja jonë ka qenë që ta fillojmë sivjet këtë kompleks qeveritar dhe ne kemi vazhduar kontakte të vazhdueshme me autoritetet komunale, që t'i përfundojnë punët rreth planit urbanistik, mirëpo për shkaqe objektive, Komuna e Prishtinës nuk ka arritur që sivjet ta bëjë planin e plotë urbanistik në lagjen Ajvalia, ku do të fillojë ndërtimi i kompleksit qeveritar. Për këtë arsye, i është rekomanduar Ministrisë së Financave që të bëjë një ndryshim në Projektligjin për buxhetin dhe të bëjë një ridestinim të mjeteve nga pozicioni "Kompleksi qeveritar", në pozicionin "Pallati i Mediave".

Ministria e Shërbimeve Publike është në përfundim të procedurave për fillimin e punimeve në Pallatin e Mediave dhe ka një dinamikë të caktuar që ky objekt, i cili edhe ashtu tash ka mbetur i pashfrytëzuar që një kohë, të shfrytëzohet dhe të vihet në funksion për nevoja të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Të nderuar deputetë,

Të gjithë ju i dini problemet që kemi me performansën e institucioneve tona, të ministrive tona, duke vepruar në institucione private. Tani pas pavarësisë, edhe objektet kanë një rëndësi për dukjen dhe pamjen e institucioneve. Ne po mundohemi që të krijojmë standarde ndërkombëtare edhe sa u përket objekteve, sa u përket kushteve dhe standardeve që duhet t'i plotësojnë objektet për t'u përdorë për nevoja qeveritare.

Në këtë rast, fjala është për një procedurë ligjore, e cila parashihet me ligjet në fuqi, që Ministria e Financave do të mundet që me kërkesën e Kuvendit, i cili edhe e ka miratuar buxhetin, të kërkojë ridestinime të mjeteve me qëllim të realizimit të vendimeve të caktuara të Qeverisë. Andaj, ju lus që ta përkrahni këtë kërkesë të Ministrisë së Financave dhe të lejoni këtë ndryshim në Buxhetin e Kosovës. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit, zoti ministër!

Fjalën e ka kërkuar kryetari i Komisionit për Buxhet dhe Financa, deputeti Gani Koci.

GANI KOCI: Ju faleminderit, zoti kryetar i Kuvendit!

I nderuari, zoti zëvendëskryeministër,

Ministra të nderuar,

Të respektuar deputetë,

Kërkesa e Ministrisë për Ekonomi dhe Financa është e bazuar ligjërisht dhe unë vetëm dua t'ju përkujtoj se arsyetimi i kësaj kërkesë është bërë në 6 pika, sipas propozimit të tyre. Duke pasur parasysh gjendjen vërtet jo të mirë të funksionimit të institucioneve të Kosovës, dhe një pjesë shumë e madhe e tyre aktivitetin e kanë zhvilluar dhe akoma e zhvillojnë nëpër ndërtesa private edhe aso që ndoshta nuk i kanë përfillur ligjet dhe procedurat e ndërtimit të tyre, prandaj ka hartuar strategjinë për akomodimin e institucioneve qeveritare. Duke u nisur nga kjo, këto pika konsistojnë në atë se kostoja shumë e lartë e qirave, nën një, kostoja e lartë e mirëmbajtjes dhe e shërbimeve komunale për objektet private, mosefikasiteti i funksionimit dhe bashkëpunimit të stafit mes institucioneve, distancës, largësisë tepër zëmadhe, pastaj edhe paqartësia rreth pronësisë së objekteve që kanë pasur dhe kanë akoma karakterin publik dhe shoqëror dhe që shfrytëzohen prej mekanizmave ndërkombëtar, dhe, arsye tjetër, mosorientimi i duhur i qytetarëve që të realizojnë kërkesat dhe nevojat e tyre për shkak të kësaj shkapërderdhjeje.

Komisioni për Buxhet ka marrë këtë kërkesë me datë 22.04.2008 dhe në mbështetje të Rregullores së Punës së Kuvendit, po edhe të Ligjit mbi buxhetin për vitin 2008, ka shqyrtuar këtë propozim dhe i rekomandon Kuvendit të Kosovës që të miratohet kjo kërkesë për ridestinimin e mjeteve nga projekti kapital "Kompleksi i ri i objekteve të Qeverisë", nën kodin buxhetor 100012, në shumën prej 8.411.478 euro, në projektin po ashtu kapital: "Renovimi i Pallatit të Mediave" në shumë prej 7.494.479 euro. Duke pasur parasysh nenin 10, pika 3 të Ligjit për buxhet për vitin 2008, për transferet e tilla që e kalojnë përqindjen e caktuar mbi 40%, vendimet duhet të merren në Kuvend, prandaj ftoj Kuvendin që ta përkrahë këtë rekomandim të Komisionit për Buxhet dhe njëkohësisht dua të them se edhe Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës i mbështet këto rekomandime të Komisionit për Buxhet dhe ftojme edhe grupet e tjera dhe të gjithë deputetët, duke pasur parasysh nevojën e ngutshme për këtë çështje, që ta miratojnë këtë rekomandim dhe këtë propozim të Qeverisë.

KRYETARI: Ju faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike, deputeti Lutfi Haziri e ka kërkuar fjalën.

LUTFI HAZIRI: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Ju faleminderit, ministër, për elaborimin e Projektit të Qeverisë, respektivisht të ministrit rreth vendosjes dhe akomodimit të stafit qeveritar!

Për Grupin Parlamentar të LDK-së dinamika nën fazën dy, që e keni paraqitur këtu, i ka dy probleme serioze. Problemi i parë serioz ka të bëjë me pronësinë e këtij objekti, sepse edhe Ligji i miratuar nga ky Kuvend para disa ditëve për Agjencionin e Privatizimit, titullar të vetëm të pronës shoqërore e njeh Agjencionin.

Ju përkujtoj se fillimi i punimeve të kësaj ndërtese është ndërprerë me kërkesën e Agjencionit Kosovar të Mirëbesimit në atë kohë, ku zëvendësudrejtori i ngarkuar për ndërmarrje shoqërore, ministri aktual, zoti Ahmet Shala, ka kërkuar të Qeveria ose t'i ndërpresë punimet, ose ta pranojë që nuk mund të llogaritet asnjëherë në investime qeveritare sepse objekti do të dalë në shitje. Edhe më tutje nuk kanë pushuar këto arsye rreth pronësisë së objektit. Në dy, ky objekt dhe rreth këtij objekti kemi problem gjyqësor, ende nuk është mbyllur lënda. Si rast i tillë, unë kërkoj që Qeveria ta ketë parasysh këtë problem serioz, sepse prona shoqërore edhe më tutje ju takon sipas rregullativës së punës së Agjencionit, duhet të jetë e qartë dhe nuk mund të pranojmë që të bëhen investimi, 7 milion investime në një objekt në këtë fazë, nëse Agjencioni i Privatizimit pas disa muajve e qet në shitje objektin dhe nuk i njeh në asnjë formë investimet e Qeverisë.

Këto janë dy probleme serioze që ne i kemi parë në këtë projekt. Nëse zëvendëskryeministri ose ju e sqaroni po ashtu se a e ka ndërruar Qeveria vendimin, Qeveria aktuale vendimin mbi Kompleksin qeveritar, ku parashihen të vendosen të gjitha ministritë dhe e gjithë administrata qeveritare, administrata publike në objekte qeveritare në Prishtinë. Edhe ky është problem formal. Qeveria mund ta bëjë formalisht kur të dojë këtë çështje, por duhet para se të vijë këtu, duhet të jetë i qartë vendimi i Qeverisë, a kemi ndryshim të vendimeve apo nuk kemi.

Këto dy problem, ju kisha lutur t'i keni parasysh, sepse janë problem për Grupin Parlamentar të LDK-së. Ne nuk besojmë se duhet ta harxhojmë buxhet në zgjidhje të shpejta të problemeve që Qeveria i ka parasysh.

Më lejoni ta përmbledh krejt këtë punë, absolutisht. Në çdo rrethanë, ne e mbështesim angazhimin e Qeverisë për zgjidhjen e problemit dhe zvogëlimin deri në zero të parave publike për të paguar qira dhe për t'i zgjidhur problemet me të cilat jemi ballafaquar në këto tetë vitet. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Unë kam dashur në fillim ta them një fjalë. Më lejoni ta shfrytëzoj pozitën, të nderuar deputetë!

Unë kërkoj nga grupet parlamentare, nga grupet parlamentare në përgjithësi që të jenë në shërbim të mirëvajtjes së punës së Kuvendit dhe ta ndihmojmë punën e Kuvendit dhe, vërtet, mos të vijnë me... Ne e patëm një rekomandim të Komisionit, që përbëhet nga të gjitha grupet parlamentare, dhe i pamë rekomandimet. Kisha lutur që grupet parlamentare të jenë në shërbim të funksionalizimit të punës së Kuvendit. Nëse ata kanë probleme mes veti, le të rikonfigurohen grupet parlamentare, por mos të na krijojnë probleme.

Vazhdojmë. Fjalën e ka deputeti Ibrahim Gashi, në emër të AKR-së. Urdhëro! Lus regjinë që në emër të kartelës së Ibrahim Makollit, t'ia japë fjalën Ibrahim Gashit!

IBAHIM GASHI: Ju faleminderit, zotëri Kryetar!
I nderuar zëvendëskryeministër, ministra,
Kolegë deputetë,

Ne si Grup Parlamentar e përshëndesim seriozitetin e Qeverisë aktuale për të tejkaluar gjendjen e akomodimit të institucioneve qeveritare, çfarë ka qenë deri më tani nga institucionet private në institucione publike.

Natyrisht, e dimë që edhe kostoja e çfarëdo investimi për të ndërtuar institucione qeveritare është prapë më e favorshme se sa qiraja që paguhet aktualisht për akomodimet në objekte private dhe, në parim, e mbështesim këtë nismë. Natyrisht, i kemi edhe ne shqetësimet edhe vërejtjet që i ngriti Grupi Parlamentar i LDK-së lidhur me çështjen e pronësisë së objektit në fjalë, e cila mendojmë se patjetër duhet të jetë paraprakisht e definuar qartë para se të ndodhë investimi. Natyrisht, kemi edhe një vërejtje të vogël te kostoja. Nëse objekti qeveritar, ose rezidenca qeveritare është parashikuar që mund të kushtojë 8.4 milion e diçka, dhe renovimi i një objekti që është godinë tashmë, do me thënë, si konstruksion e gatshme, vetëm renovimi të kushtojë vetëm 1 milion euro më pak, duhet një specifikim më i madh se për çfarë shkalle të renovimit bëhet fjalë, për arsye se shuma është mjaft e përafërt me shumën për ndërtimin e një objekti nga zeroja. Do të thotë, edhe me këto dy vërejtje, do me thënë, të pronësisë dhe të kalkulimit se për çfarë shkalle renovimi bëhet fjalë, Grupi Parlamentar i AKR-së e mbështet, sepse bëhet fjalë për një domosdo për akomodimin e institucioneve qeveritare. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! Ju njoftoj se shkollat edhe pse janë ndërmarrje shoqërore, mësuesit nuk kanë të drejtë në atë pronë. Të gjitha objektet e Qeverisë e kanë të njëjtin status, kështu që mos u merakosni. Mos është ndonjë kërkesë tjetër për të ruajtur qiramarrësit që nuk janë të pakët për zyrat e qeveritarëve.

Fjalën ia jap shefit të Grupit të AAK-së, Ardian Gjini.

ARDIAN GJINI: Ju faleminderit, zoti Kryetar!
Për të mos i përsëritur kolegët, edhe ne si grup parlamentar i kemi dilemat tona për dy ose tri çështje që kanë të bëjnë me këtë propozim të Qeverisë. E para, është çështja se ne e konsiderojmë si kthim prapa prej një plani i cili ka ekzistuar për ndërtimin e kompleksit, e konsiderojmë si kthim prapa. Çështja e dytë është se edhe nëse shkohet kështu, nuk besojmë se do të mund të përfundohet ashtu si duhet. E kemi një propozim ose një vendim të Qeverisë shumë pompoz prej fillimit të këtij viti, prej janarit, do të thotë, që të gjitha ministritë që janë nëpër objekte private do të dalin. Sot jemi në qershor, dhe marrim ose nuk marrim vendim për ridedikim të mjeteve dhe nëse ndiqen procedurat normale të tenderimit, do të përfundojë viti dhe prapë se prapë do të jetë njëjtë.

Çështja tjetër, është çështja e pronësisë. U përmend këtu, nuk do të kthehem prapa, është çështje që Qeveria e kaluar ka qenë e detyruar ta ndërpresë atë çështje ekzakt për

shkak të asaj që sot e tha zoti Lutfi Haziri e që është kërkesa e AKM-së dhe me siguri ministri aktual ka pasur mundësi që t'ia sqarojë Qeverisë pse ka ndodhur ashtu.

Çështja tjetër, është çështja e mjeteve të cilat shpenzohen. Ne e dimë se një kohë diku para një 5 apo 6 viteve ka pasur një renovim në Pallatin e mediave, nuk e kemi shumë të qartë se si ka ndodhur, tash ndodhë edhe një renovim tjetër, dhe renovimi i një objekti ekzistues, i cili kapë shumën prej 7.5 milion eurove për ne është i pajustificueshëm në cilindo variant, aq më tepër kur atij objekt mund të ndodhë që do t'i ndërrohet edhe pronësia. Nëse ndërtimi i objekteve të reja kushton pak më shumë se renovimi i një objekti, i cili po rinovohet që 10 vjet, ne mendojmë se prapëseprapë edhe këtu ka vend për shumë diskutim, një diskutim më të gjatë e jo këso forme e diskutimit.

Në përgjithësi, do të thotë, duke i pasur parasysh të gjitha këto, jo për ndonjë arsye tjetër, zoti Kryetar, ne mendojmë se Qeveria nuk mund të gjejë zgjidhje të shpejta vetëm për shkak të një vendimi që është marrë më herët, por duhet të punojë në akomodimin afatgjatë të institucioneve të Kosovës në planin i cili është hartuar më herët. Për këtë arsye, ne nuk do ta votojmë këtë propozim. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, Berim Ramosaj e ka fjalën.

BERIM RAMOSAJ: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar ministra,

Kolegë deputetë,

Në fakt, shumicën e gjërave që desha t'i qes në pah, i thanë kolegët e mëparshëm, veçanërisht ai i LDK-së dhe përfaqësuesi i AAK-së. Mirëpo, ajo çka është për t'u theksuar në moment, është se kërkesa e Ministrisë së Financave për alokim të mjeteve, mbështetet në Ligj, si kërkesë financiare, por për çdo projekt që dëshirohet të implementohet, qoftë në nivel qeveritar, qoftë nivel të pushtetit lokal, duhet së pari të sigurohet dokumentacioni përkatës. Unë, sa e shoh, në këtë dokumentacion për alokimin e këtyre mjeteve nuk qëndron as leja, respektivisht çështja e sqarimit të titullarit të atij objekti. Kjo vlen për Kryetarin e Kuvendit, nuk është objekt publik, por është objekt shoqëror, sepse pronësia shoqërore dhe publike dallojnë shumë, e në qoftë se është objekt shoqëror, së pari duhet të shqyrtohet çështja e titullarit të pronës së Rilindjes, si ndërmarrje shoqërore, e pastaj të krijohen apo të implementohen projekte të natyrës së tillë. Andaj, komplikimet e tilla, të cilat mund të ndodhin si rezultat i mos sqarimit të titullarit, respektivisht të pronës, mund të neglizhojnë edhe këto mjete të alokuara nëse ndodhë një gjë e tillë.

Andaj, këtë që po e themi, është sigurisht lehtësim për Qeverinë, që mos të kërkojë mjete apo mos të përgatit projekte të cilat nuk e kanë të sqaruar çështjen e pronësisë, sepse çështje kryesore duhet të jetë së pari definimi i pronësisë sa u përket këtyre objekteve, edhe për objektin e Rilindjes, edhe për objekte të tjera, e pastaj mund të bëjë kërkesën për alokim. Krejt kërkesa që ka ndodhur deri tash, është e natyrës së tillë se a ka të drejtë në aspektin e ligjshmërisë për alokim mbi 40% kur janë në pyetje projektet e ngjashme. Ajo ka të drejtë, por nuk është e sqaruar çështja e titullarit të pronës, respektivisht nuk ka plan urbanistik. Jeni të mbështetur si Qeveri, jeni të mbështetur si Qeveri vetëm në planin strategjik për objekte të natyrës qeveritare, e kur janë ndarë

mjetet në fillim për projekt, janë ndarë për ndërtimin e Kompleksit qeveritar. Nuk mund të jetë Kompleks qeveritar objekti i Rilindjes.

Së pari, të sqarohet çështja e titullarit të këtij objekti dhe e objekteve të tjera, e atëherë mund të bëhet edhe alokimi i mjeteve. Ajo çka është edhe më e dhimbshme në këtë moment, ajo që keni thënë në fillim të qeverisjes, zoti Thaçi që ka thënë që do të barten krejt ministritë nga objektet private, ajo nuk është realizuar. Dyshoj që edhe me këtë qasje që keni, do të mbeteni edhe shumë vite, në qoftë se mbeteni në Qeveri, dhe nuk mund të barten institucionet e juaja në objekte. Më mirë është që këto mjete që i keni në dispozicion, të ndërtoni, ndoshta nëse ka nevojë një Kampus qeveritar se sa të shkoni të futni mjete në ndërmarrje shoqërore, të cilat nesër kanë për të ndryshuar, ndoshta ka për të ndryshuar edhe titullari, respektivisht ka për t'ju kthyer titullarit të vjetër.

Andaj, edhe një herë në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, ne nuk do ta përkrahim, sepse me këtë qasje e ndihmojmë në fakt Qeverinë. Ju faleminderit.

KRYETARI: Ju faleminderit, zoti profesor! Ekonomist jeni dhe e dini se për gjashtë muaj nuk ndërtohet Kompleksi qeveritar. Ju faleminderit shumë për atë që e the!
Fjalën e ka Grupi “7+”, deputeti Sadik Idriz.

SADIK IDRIZ: Za nas nije problem da podržimo destinaciju ovih sredstava iz jednog budžetskog koda u drugi. To je mislim, pravo Skupštine, i to čim ova suma prelazi odredjeni procenat, o tome odlučuje Skupština. To nije nikakav problem.

Medjutim, vidimo da je problem i kod većine parlamentarnih grupa pitanje vlasništva i postoji jedna dilema. Drugi problem je što ministar nije ovde da objasni kako je došlo, znači u ovom periodu da je bio problem, sada nije problem. Ako je ranije bio problem, sada nije, šta se u medjuvremenu dogodilo da više nije problem vlasništva i da možemo mi to da uradimo...

U Vladi, u kojoj sam bio u prethodnom mandatu, zaustavljeni su, prekinuti su radovi na ovom kompleksu iz razloga što su se pojavili problemi vlasništva i neki drugi problemi koji su verovatno poznati.

Mi nemamo problem da glasamo, ali ako ove dileme postoje, ako postoje kod Parlamentarne grupe koja je u koaliciji, prvo da vam kažem kod LDK postoji dilema, ako postoji kod ovih drugih, mislim da bi bilo dobro da je tu ministar ekonomije, da objasni da nas ubjedi. Nije problem da glasamo, nego je problem kako ubediti poslanike da glasaju. Kada mene neko ubedi, onda više niko nije taj što može da zaustavi i da me ubedjuje, znači nemoj ili da nisam, da ja ne znam, ili ne razumemo neke stvari. Ako sam ja, ako me je neko ubedio, ja razumem stvari, ako me nije ubedio, ne može, ne može time što će reći da je to dobro, da je to odlično, da su neki vremenski uslovi, da su to neka vremenska ograničenja, da za 6 meseci ne može, 7,5 miliona uložiti u zgradu koja je diskutabilna, sa 7,5 miliona mislim da se može napraviti jedna takva zgrada, i to su sigurne stvari. To je bio razlog zašto su i prekinuti radovi, jer mnogi su rekli onda, ne znam koliko je isto bilo, možda i više miliona, rekli su da se sa tim milionima može napraviti jedna zgrada od temelja i koja će biti sigurna, bez problema.

U svakom slučaju, mi ćemo prihvatiti redestinaciju sredstava ukoliko budemo ubedjeni da to nema nekih problema sa vlasništvom i nekim drugim stvarima. Hvala!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Fjalën e ka Grupi Parlamentar i SLS-së.

E do dikush fjalën? Jo! Atëherë, vazhdojmë me diskutimet e deputetëve.

Fjalën e ka deputeti Gani Koci, pasi i dha rekomandimet.

GANI KOCI: Ju Faleminderit, zoti Kryetar!

Unë paraprakisht jam i shqetësuar me shkallën e informimit të deputetëve lidhur me ligjet dhe me ato çështjet që i shtruan këtu. Në javën e kaluar, me sa më duket, ne e kemi miratuar një ligj mbi ndërmarrjet publike dhe shoqërore dhe kush e ka lexuar atë, e ka parë që në dispozitat e para thuhet se me këto ndërmarrje menaxhon dhe mbikëqyrë Qeveria e Kosovës dhe se të gjitha asetet e këtyre ndërmarrjeve janë pronë e shtetit të Kosovës dhe mbi to ka dorë Qeveria e Kosovës. Nëse është kështu, prandaj çështja e pronësisë dhe dilemat rreth pronësisë të këtyre ndërmarrjeve, mua më duket se janë hequr, tashmë janë hequr, bile së paku pas 15 qershorit të këtij viti, dhe nuk do të dëshiroja që këtë çështje ta shtrojmë si problematikë rreth titullarit të pronësisë.

Sa i përket asaj se nesër mund të privatizohet, po ashtu ne kemi një Ligj të miratuar mbi Agjencionin që e kemi quajtur tash Kosovar të Privatizimit dhe që i nënshtrohet komplet ai ligj dispozitave të Kushtetutës dhe dispozitave të tjera ligjore që i ka nxjerrë ky Kuvend këtu. Nuk konsideroj se kjo do të duhej të ishte pengesë, nëse ka qenë pengesë në mandatin e Qeverisë së kaluar që të vazhdohet rreth pronësisë, sepse ju e dini, Organizata e Kombeve të Bashkuara ka pasur, ka qenë titullar i pronës në Kosovë, dhe tashmë nuk është kjo, kjo dilemë duhet të hiqet.

Çështja tjetër, në qoftë se vërtet ne dëshirojmë akoma që Qeveria të zhvillojë aktivitetin e vet në objekte private prej të cilave kanë përfutur dhe përfitojnë edhe direkt edhe indirekt personalitete të caktuara, atëherë ne mund të bëhemi pengesë në këtë Kuvend, që vërtet mos ta miratojmë këtë propozim të Qeverisë.

Në anën tjetër, shuma që u përmend këtu prej 8 milionëve për projektin rreth rezidendave qeveritare, nuk është shumë se me 8 milion ne do t'i bëjmë ato 11 pallate të Qeverisë, por është një shumë që të fillohet projekti për vitin 2008 dhe është vetëm një pjesë e asaj që nevojitet për realizimin e atij projekti, do të thotë është fazë e parë e realizimit të atij projekti.

Këto çështje, mendoj se kur t'i përmendim dhe kur diskutojmë, do të duhej mirë të analizoheshin dhe pastaj mbi bazën e tyre të vijmë deri te vendimi.

Objekti i "Rilindjes" është objekt i Qeverisë së Kosovës, në fund të fundit edhe me historik po të merremi, ka qenë Pallat i Rilindjes, Rilindja ka qenë një ndërmarrje publike dhe atë ndërmarrje e ka themeluar ish Kuvendi i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, dhe ajo pronë e ish Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës tash është pronë e Republikës së Kosovës. Ky është fakti dhe mbi këtë fakt, ne duhet të veprojmë.

KRYETARI : Ju faleminderit!

Fjalën e ka kërkuar deputeti Riza Smaka.

RIZA SMAKA: Ju faleminderit, zori Kryetar!

Të nderuar qeveritar dhe deputetë,

Ju lutem, mendoj që nuk duhet apriori të hezitohet e të nxjerrim opstruksione të cilat latente e ekzistente, që determinojnë nga rendi juridik i Kosovës që është shumë problematik, do të jetë për një kohë të gjatë, mjerisht, prandaj ne do të duhej ta inkurajonim Qeverinë që, natyrisht, në konformitet me Ligjin, me procedurat, e ato, do të përballet, por ato janë të tejkalushme, kështu që këtë çështje ishte dashur ta heqim nga konteksti.

Ekspozeja e ministrit të Shërbimeve Publike ishte korrekte, ishte e logjikshme. Edhe unë mendoj që është një aspiratë sublime që, ju lutem, ndër të tjera të minimizohen, nëse është e mundur, apo së paku të pakësohen shpenzimet tepër të larta të qirave të objekteve private nga Qeveria, ministritë tona në objektet private është një kolizion, është një kontradikcion me moralitetin e me legalitetin e me të gjitha postulatet elementare. Kjo nuk mund të ndodhë, prandaj do të duhej bëhej krejt ajo që është e mundur edhe atë sa më shpejtë që është e mundur, në mënyrë që Qeveria të vendoset në objektet qeveritare.

Unë do ta kisha shfrytëzuar rastin në këtë kontest, bile do t'i kisha apeluar profesorit Bajrami, sepse është ministër i kësaj Ministrie për Shërbimet Publike, mendoj ma kompetente që të ngrejë një ekip dhe të bëjë diçka që është e mundur sa u përket normativave dhe standardeve të nëpunësve civil. Unë vlerësoj, kam edhe të dhëna, por do të delte jashtë kontestit, se në Qeveri ka shumë nëpunës, ka shumë më tepër se sa që ka nevojë çfarëdo qeverie, aq më parë kur, sot po e zëmë, është automatizimi në pyetje. Nuk ka nëpunës që nuk e ka një kompjuter. Prandaj, problemi i madh është vendosja e tyre dhe është fjala për punësim inproduktiv, prandaj, në këtë drejtim do të isha angazhuar që po qe se është e mundur të bëhet një analizë dhe një dokument dhe të reduktohet administrata për aq sa është e mundur dhe, përfundimisht, e mbështesë profesorin Bajrami me ide edhe me koncept të pranueshëm. Ishte edhe diskutimi i kolegut Koci, që ishte plotësisht në harmoni me këtë që desha ta them, prandaj po e shkurttoj diskutimin për hir të kohës. Ju faleminderit shumë!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Fjalën e ka deputeti Naim Maloku.

NAIM MALOKU: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Unë nuk e kam pasur ndërmend ta marr fjalën për këtë pikë të rendit të ditës, mirëpo pasi që vota ime do të jetë kundër këtij rekomandimi, dhe njëfarë forme ju dhatë për të kuptuar me një shpjegim se vota “kundër” do të thotë që t’ju shkojë në favor të pronarëve që kanë dhënë objektet dhe që i kanë dhënë me qira Qeverisë së Kosovës, unë desha t’ju sqaroj juve, zoti kryetar, deputetëve dhe qytetarëve të Kosovës se vota ime kundër këtij rekomandimi nuk do të thotë se i përkrahi qiramarrësit ose qiradhënësit. Vota ime “kundër”, zoti kryetar dhe të nderuar deputetë, bazohet në bindjen time, duke u bazuar në këto tri shkaqe:

1. Më është e njohur që objekti në fjalë është në kontest gjyqësor dhe para se të vijë ky rekomandim, për shkak të prishjes të kontratës për një tender që është dhënë përpara për t’u rinovuar,

2. Për shkak se vetë ministri që kërkon këtë ridestitim, ka qenë shkaktari dhe nxitësi i ndërprerjes së atij tenderi.

3. Për shkak se me këtë rekomandim dhe ridestitim po zhagitet dhe po prolongohet projekti, kompleksi i ri i objekteve të Qeverisë, që është miratuar ky projekt me buxhetin e këtij viti, në këtë Kuvend, dhe ky është shkaku dhe ky prolongim i këtij projekti dhe ky ridestitim, sipas mendimit tim dhe bindes sime, po ju shkon për shtati atyre që ia kanë dhënë objektet me qira Qeverisë së Kosovës. Këtu duhet të gjenden dhe të kërkohej kush ka interesa që të prolongohet kjo. Që 6 muaj nuk punohet në atë projekt dhe tani t'i hiqen edhe të hollat që janë ndarë për atë projekt dhe të ridestitohen dhe tash t'i hyhet procesit të tenderimit, të ritenderimit, të ankesave dhe këtë vit fare nuk do të mund në aspektin procedural të fillojë renovimi i atij objekti, që sipas bindjes sime, zoti kryetar, është vendim diskutabil dhe kjo është arsyeja pse unë votoj "kundër". Unë votoj "për" dhe kam qenë për kompleksin e ri të objekteve të Qeverisë dhe që me këto 8.400.000 që kanë qenë të ndara për këtë projekt, të fillojë implementimi dhe zbatimi dhe mos të zhagitet puna rreth këtij projekti. Ju faleminderit, Kryetar!

KRYETARI: Ju faleminderit deputet! Nuk është kërkesa ime, kërkesa është e Qeverisë. Fjalën e ka kërkuar deputeti Bahri Hyseni.

BAHRI HYSENI: Ju faleminderit, zoti Kryetar!
Përshëndetje të nderuar ministra,
Përshëndetje të nderuar kolegë deputetë,

Pa dashje që t'i përsëris fjalët që i tha zoti Koci, por është mirë pak t'i sqarojmë gjërat.

Çështja e parë është për t'u falënderuar vendimi i Qeverisë, që ka marrë vendim që për një kohë të shkurtër institucionet e Kosovës të mos jenë në vendbanimet private, sepse qiratë janë shumë të mëdha dhe, natyrisht, me këtë humbim ne si qytetarë, institucionet dhe gjithsesi edhe Kosova në përgjithësi.

U ngrit një çështje për të cilën mendoj që nuk po flasim drejt. Sot është ngritur çështja e ridestinitimit të mjeteve, që është çështje ligjore dhe për të cilën duhet të përcaktohet Kuvendi i Kosovës, sepse përndryshe do t'ia lëmë mundësinë dikujt tjetër, ndoshta me nënshkrimin e vet ta bartë këtë të drejtë dhe t'i bartë mjetet e llogarisë në llogari për të mos penguar punën e institucioneve të Kosovës.

Çështje tjetër, po diskutohet për pronën dhe për statusin e ndërmarrjeve publike apo shoqërore. Me plotë përgjegjësi po them se çështja e ndërtesës së Rilindjes ende e ka të padefinuar statusin dhe nuk mund t'i themi plotësisht se është ndërtesë me karakter shoqëror, duke pasur parasysh se themeluesi i saj është ish Kuvendi i Kosovës. Prandaj, nuk mund t'i thuhet në këtë seancë plenare sepse nuk e ka statusin e qartë, a është ndërmarrje me karakter shoqërore, apo është ndërmarrje me karakter publik. Kjo është çështja e parë. Çështja e dytë, nëse i marrim letrat të cilat kanë ardhur si rekomandim nga Agjensioni Kosovar i Mirëbesimit, t'ju them të vërtetën të gjitha ministratë e Qeverisë së Kosovës sot do të ishin në ndërtesa private.

Ndërtesa e Shërbimeve Publike, aktualisht ku punon Ministria e Shërbimeve Publike, e ka pasur një letër të njëjtë sikurse Rilindja. Avokati i Popullit dhe Instituti i

Administratës Publike sot në Kosovë, e ka pasur një letër të tillë. Banka Popullore, në të cilën është e vendosur Qeveria e Kosovës, e ka pasur një letër të tillë. Sipas kësaj, asnjë vendosje e ministrive nuk ka dashur të bëhet në këto institucione për shkak të gjëja pronësisë. Mirëpo, nëse jeni në dijeni, faktori ndërkombëtar dhe Përfaqësuesi i parë Special, me ardhjen në Kosovë ka nxjerrë një letër me të cilën ka marrë vendim që të gjitha ndërtesat, të cilat janë me karakter publik dhe shoqëror, për interes të institucioneve të Kosovës mund të përdoren dhe, natyrisht, ku ka interes ato mund të vendosen, qoftë faktori ndërkombëtar, qoftë institucionet e Kosovës.

Duke u bazuar në këtë letër, edhe Qeveria e parë, por shpresoj që edhe Qeveria në vazhdim është vendosur në këto institucione. Ju e dini, po të ishte respektuar vendimi i AKM-së, në këtë rast, dhe i Dhomës Speciale, Gjykatës Supreme të Kosovës, nëse institucionet e Kosovës sot do të kishim supermarkete. Ju e dini që ka qenë supermarketi më i madh në Prishtinë në ndërtesën e Ministrisë të Shërbimeve Publike. Prandaj, është mirë që si deputet të bëjmë një sqarim. Tani institucionet e Kosovës po kërkojnë që mjetet të lëvizin prej një llogarie në llogari tjetër, ku nuk janë të parapara vetëm për kompleksin e ndërtesave qeveritare, janë të parapara për vendosje dhe akomodim të institucioneve në Kosovë, dhe këtu ndoshta është mirë të mos hezitojmë.

Sa i përket çështjes se si është ndalë, si është pezulluar kjo çështje, për këtë mund të debatojmë qoftë një këtë seancë, apo në një seancë tjetër, dhe të shikojmë arsyet e ndaljes, a ka pasur arsye, pse është ndalë, kush e ka marrë vendimin, si është marrë vendimi, cili autoritet ka të drejtë ta prishë kontratën e Njësisë Qendrore të Prokurimit, ku është lënda, pse janë dhënë paratë, si janë dhënë paratë, është çështje për të cilën me siguri që deputetët dhe qytetarët e Kosovës janë të interesuar të dinë, mirëpo mendoj që të mos i përziejme tash pikat e rendit të punës. Sot bisedojmë për këtë çështje, mos t'i pengojmë institucionet, ta heqin këtë dukuri negative, sepse ju po diskutoni për 7.000.000 euro që do të kushton riparimi, po edhe në qoftë se i mbetet Pallatit të Rinisë, fundi i fundit po bëhet dhe po punohet për institucionet e Kosovës.

Me mijëra milionë euro janë duke humbur për qira. Me qindra milionë euro janë duke humbur nga fillimi se nuk dihet ku janë të vendosura institucionet, çfarë shërbime paguajnë marramendëse, çfarë shërbime paguajnë për shërbimet komunale e kështu me radhë. Më mirë është të ndërtojmë objekte të cilat fundi i fundit i mbesin Kosovës dhe institucioneve të Kosovës.

Dhe, krejt në fund, është shumë e qartë edhe ajo që u ngrit. Tani e kemi edhe Ligjin. Ligjin që e kemi votuar disa javë dhe shumë qartë thotë se këto janë pronë e institucioneve të Kosovës, në radhë të parë të institucioneve me të cilat menaxhon Qeveria e Kosovës. Prandaj, këtu nuk ka asnjë dilemë dhe është mirë që mos t'i bëjmë pengesë apo me vetëdije të mos krijojmë rrethana që të përfitojnë njerëzit privat dhe të humbin në këtë rast institucionet dhe ne, dhe askush nuk humbë, vetëm qytetarët e Kosovës që po e humbin buxhetin për çdo ditë, duke paguar qira pa nevojë dhe natyrisht nuk ka as vend adekuat dhe për njerëzit të cilët po punojnë për institucione. Ju faleminderit shumë!

KRYETARI: Ju faleminderit, pauzë deri në orën 12,30 minuta.

Vazhdimi i seancës pas pauze

KRYETARI: Të nderuar deputetë, meqë kemi kuorum, mund të fillojmë debatin. Fjalën e ka deputetja Gjylnaze Syla.

GJYLNAZE SYLA: Faleminderit, zoti Kryetar!

I nderuar, zoti Kryetar,

E nderuara ministre,

Të nderuar deputetë,

Ne sot po shqyrtojmë një çështje shumë të rëndësishme të rialokimit të mjeteve nga projekti kapital: “Kompleksi i objekteve të Qeverisë” në projektin kapital: “Renovimi i Pallatit të Mediave”.

Të nderuar deputetë, ju ftoj që vendimin ta merrni në bazë të asaj se çka është në interes të qytetarëve të Kosovës dhe unë do t’i numëroj argumentet:

E para, Qeveria duhet të ofrojë një zgjidhje të qëndrueshme, jo një zgjidhje afatshkurtër dhe ad-hoc.

E dyta, duhet menduar në vetë shpenzimin e këtyre parave, që do të thotë se ne, si deputetë, jemi të përgjegjshëm që të mendojmë se si shpenzohet paraja publike. Në qoftë se për gjithë kompleksin nevojiten 8.5 milion, ndërsa vetëm për renovimin e Pallatit të Mediave 7.5 milion, atëherë duhet menduar se cila është zgjidhja më e mirë. Më mirë është të shpenzohet 8.5 për ndërtimin e kompleksit se sa 7.5 për renovim. Dhe, unë po thirrrem këtu në vetë projektin, të cilin e ka ofruar Qeveria, në të cilin shkruan se renovimi i Pallatit të Mediave kap vlerën prej 7.234.000, plus mbikëqyrja profesionale 250.000 euro, plus shumëzimi i dokumentacionit teknik 10.000 dhe shpallja e tenderëve për secilën pikë të projektit.

Tjetra është se në dokumentacionin, të cilin e ka ofruar Qeveria, ne nuk kemi të dhëna për zhvillimin e projektit, si do të zhvillohet projekti i saktë dhe ato të dhëna, zoti ministër, që janë ofruar, janë të pasakta. Unë i referohem prapë dokumentit, ku thotë kështu: “Pikat referuese të projektit: Fillimi i projektit: data 31. 3. 2008; Përgatitja e dokumentacionit: Më 12.9 thotë, bëhet përzgjedhja e ofertuesve të realizimit të punëve, kurse më 12.2.2008 përfundimet e punimeve”. Ju e kuptoni që, do me thënë, para se të zgjedhet ofertuesi, po përfundojnë punimet.

Në fund, të gjithë këto, janë faktorë që nuk bindin se mundet ky projekt, gjegjësisht s’është projekt i qëndrueshëm.

E katërta, mendoj që kolegët e mi deputetë, veç e cekën edhe çështjen e kontestit gjyqësor, por po ashtu edhe të pronësisë.

Prandaj, rekomandimi im Kuvendit është që t’i propozojë Qeverisë dhe të kërkojë nga Qeveria që të përqendrohet dhe angazhohet në ndërtimin sa më të shpejtë të kompleksit qeveritar dhe po ashtu Kuvendit t’i propozojë që të bëjë monitorimin e këtij projekti të rëndësishëm kapital. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, shumë! E ka fjalën Numan Baliq. Le të përgatitet Naser Rugova.

NUMAN BALIĆ: Faleminderit, zoti Kryetar!

Želio bih da kažem nekoliko stvari koje su principijelno bitne u ovoj situaciji. Očigledno da je pitanje obnove bivše zgrade „Rilindja“ za potrebe Vlade izvadila na površini mnoga pitanja koja su bitna za sve nas i kojima trebamo u najmanju ruku ozbiljno da se pozabavimo.

Dakle, potrebno je jedno temeljito razmatranje prije donošenje bilo kakve odluke, ako ne želimo donijeti pogrešnu odluku.

Ja bih dao nekoliko primedbi, koje, čini mi se do sada manje čuli, a jedna je od tih da se mora voditi računa u slučaju rada institucija o kontinuitetu rada institucija, u ovom slučaju, o kontinuitetu politike vlada dosadašnjih na Kosovu.

Potpuno je neprihvatljivo, ili u najmanju ruku, neukusno, da prethodna vlada u potpunosti odbaci pitanje obnove ove zgrade a da sadašnja Vlada, bez mnogo razmatranja, prihvati isto pitanje.

Dakle, u politici vlada koje postoje na Kosovu, u najmanju ruku mora da ima jedan kontinuitet, a ne da postoje kontradiktorni stavovi povodom ovakvih pitanja, kao što je ovo. Ja razumijem, naravno, da se mnoge vlade u istoriji, predsednici vlada, predsednici država, ministri i tako dalje, pamte po velikim zaokretima i tako dalje, i tako dalje. Na jednoj strani, sumnjam da će ova vlada imti takve istorijske poteze, a na drugoj strani mislim da je neprihvatljivo da budu potpuno kontradiktorni u odnosu na prethodne politike koje su postojale.

Drugo, vezano za spor. Evidentno je da postoji spor. I ovo pitanje izbacuje na površinu, takodje, mnoga druga sporna pitanja koja smo imali vezano za privatizaciju – pitanje šta je društveno, šta je privatno, šta je javno, i tako dalje.

Naravno da ovo sve bi trebalo da odvede u jednu kompletnu reviziju procesa privatizacije, gde dobro znamo da je oštećen veliki broj i firmi, i radnika, i javnost i narod Kosova. Ovo nas pitanje podsjeća na to. Može neko reći da ovo možda i nema puno veza sa tim, ali itekako ima veze, posebno ako se ima u vidu koliko je bilo pogrešaka u oblasti privatizacije, odnosno odnosa karaktera prema ovim firmama.

Vezano za samu zgradu i cijenu obnove zgrade, mislim da je ona mnogo puta preoveričana. Osam i po miliona, to je zaista jako puno para. Za obnovu jedne zgrade, to je mnogo novca. Mislim da bi neki naši majstori Župe tu zgradu mogli obnoviti za pet puta manje para, bez neke temeljite procjene.

Dakle, treba voditi računa o ukupnoj situaciji, o stanju u društvu Kosova, o svim konstalacijama koja postoje i, naravno, treba donijeti pravilnu odluku.

Mislim da u ovom momentu, bez ozbiljnijeg razmatranja, bez donošenja odluke oko toga koliko je ova odluka valjana i bez ulaganja ovoliko novca, ne bi se trebalo pristupiti donošenju ove odluke. Hvala vam!

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka Naser Rugova, le të përgatitet Haki Shatri.

NASER RUGOVA: Faleminderit, zoti Kryetar!

Anëtarë të Kabinetit qeveritar,

Të çmuar kolegë deputetë,

Sot kemi përpara vetes shqyrtimin e kërkesës së Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave për ridestinimin e mjeteve për investime kapitale nga projekti: “Kompleksi i ri qeveritar” për projektin: “Renovimi i Pallatit të Mediave”.

Vetë kërkesa, ridestinim i mjeteve, nga një vendim i qeverisë së kaluar, nga ikja e një plani strategjik, thjeshtë, për vendosjen e institucioneve qendrore të Republikës së Kosovës në objektet tipike ku titullar është shteti dhe Qeveria e Kosovës dhe të kërkohet një ridestinim i tillë, i paarsyetuar mirë, zoti ministër i Shërbimeve Publike, thjeshtë na shpie para dilemave të mëdha. Pse ky ridestinim, kur bëhet fjalë për kompleksin e ri qeveritar me kod 10012 në shumë prej 8.283.000 euro, ndërsa nga buxheti i vitit 2007 në këtë kod janë bartur mjete në vlerë prej 128.478 euro dhe kjo shumë prej 8.411.478 eurove ose gati 8.5 milion euro - vërtet janë shuma të mëdha, janë mjete serioze nga buxheti i taksapaguesve kosovarë të investohen në një objekt, tashmë edhe shumë të përfolur që nuk i bën nder as Qeverisë aktuale.

Tani po flas si qytetar, po edhe si i zgjedhur i atyre qytetarëve, jo me kontekst të deputetit opozitar. Unë i bëj apel edhe Kryeministrit, edhe Kabinetit qeveritar, që t’i shqyrtojnë me vëmendje këta hapa.

Në bazë të vendimeve, thotë, të Qeverisë numër 02/4 të datës 30.1.2008 dhe numër 02/9 i datës 27.2.2008, për një vendim, që e merr Kabineti qeveritar, të cilët janë njerëz dhe njerëzit gabojnë, sigurisht që ka qenë një vendim euforik në marketingun e atyre ditëve të para kur keni ardhur në pushtet dhe është një vendim i pa analizuar si duhet dhe nuk ka mundësi të implementimit. Dhe pse të marrim hapa të shpejtuar tani dhe të bëjmë eksperimente edhe me buxhet të Kosovës, po edhe deputetët dhe ky Parlament të bien në nivel të këtij debati, sepse i kemi edhe miqtë ndërkombëtar që na kanë ndihmuar të bëjmë shtetin këtu dhe po na përcjellin me vëmendje e sidomos tani në prag të Konferencës së Donatorëve që pritet të mbahet së shpejti.

Ju lutem, kjo kërkesë e Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave, në këtë kohë dhe me këto shifra, do të thotë, është joserioze. Të vazhdohet, thjeshtë të vazhdohet me planin strategjik për akomodimin rezidencial të objekteve qeveritare në kompleksin e ri, në një pjesë të re të kryeqytetit të Republikës së Kosovës, sepse hiq kontestin gjyqësor, mungesën e titullarit, investime thjeshtë të pa analizuar si duhet – vjen nesër dikush dhe e privatizon atë objekt dhe Qeveria do të detyrohet prapë me gjithë këto investime të paguajë qira dhe kjo do të ndodhë. Andaj, pse ky ridestinim, pse të mos vazhdohet me projektin e nisur dhe thjeshtë kjo na sjell para dilemave të mëdha - mos vërtet dikush, me këtë vendim të Parlamentit, thjeshtë, që po tenton t’i orientojë këto 8 milion e gjysmë për interesa të dikujt tjetër.

Ju lutem, nuk dua të prejudioj, por unë kërkoj nga Qeveria që të tërhiqet nga ky propozim, të analizohet mirë, të studiohet si duhet dhe të dalë para Kuvendit me propozime serioze. Unë thjeshtë shpreh mendimin tim si deputet, që institucionet,

konkretisht Qeveria e Republikës së Kosovës duhet të mos nxitohet dhe të shkojë në periudha afatgjate të akomodimit të objekteve qeveritare dhe të fillojë ndërtimi i kompleksit të ri qeveritar që, njëherë e përgjithmonë, administrata shtetërore e nivelit nacional të vendoset në objekte të Qeverisë së Republikës së Kosovës. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Haki Shatri. Le të përgatitet Adem Hajdaraj.

ADEM HAJDARAJ: Zotëri Kryetar!

Ministra e deputetë të nderuar,

Unë nuk desha të marrë fjalën, mirëpo sipas kësaj që po zhvillohet këtu, nuk më duket e arsyeshme të veprohet në këtë mënyrë, në mënyrë disi si me tendencë të tërhiqen deputetët e të shkojnë në një drejtim.

E them këtë për arsye se çështja e pagesës së madhe që e bëjnë ministrinë, mua më brengos, për objekte private që janë, ose objekte të tjera. Mirëpo, logjikisht ta marrim, të futen të gjitha ato para në një renovim të një objekti të vjetruar, objekt i cili edhe po të rinovohet, nuk i zë më shumë se dy ministri dhe Kabineti qeveritar dhe ministrinë nuk do të mund të vendosen aty, pikërisht për atë se janë edhe sallat të papërshtatshme. Mua më kujtohet shumë mirë kur pikërisht nga ky objekt u larguan mediat në mënyrë më të padrejtë dhe bënë përpjekje aty që të qëndrojnë e t'i kristalizojnë dëshirat e popullit të Kosovës. Dhe ato media, pavarësisht se ishin të një sistemi tjetër, kanë bërë një luftë shumë të drejtë për ta bindur popullin se rruga jonë për pavarësi është e drejtë. Mirëpo, tash, të gjitha ato, u qitën në rrugë për arsye se e zunë institucionet ndërkombëtare atë vend dhe për to fare nuk u mendua, qoftë "Rilindjen", qoftë ato mediat e tjera që kanë qenë të vendosura aty.

Prandaj, unë mendoj se të tërhiqet ky vendim, të analizohet edhe më tej, jo të hudhet krejt dhe në një të ardhme të dilet me qëndrim të qartë. Nuk është e mundshme në asnjë mënyrë, ta zëmë, që të imponohet kjo çështje dhe të mbetemi pa objekt, edhe Qeveria, edhe Kryeministria, ministrinë e tjera, dhe të mos shkojmë në mënyrë të shpejtë, sepse unë e bëj një krahasim, nëse i kam kaq para, më mirë është t'i fus në një objekt të ri se sa t'i derdh ato në një objekt të vjetër, i cili, po ashtu është i Kosovës edhe ai objekti i vjetër dhe mund të shërbejë për diçka tjetër, por nuk është i përshtatshëm për Kabinetin qeveritar, as për ministri. Prandaj, propozoj që të tërhiqet ky propozim, unë kam qëndrim negativ për këtë çështje. Domethënë, nuk pajtohem të bëhet në këtë mënyrë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Desha t'ju përkujtoj me atë se, sistemi politik ka ndryshuar në Kosovë. Fjalën e ka Gani Buçinca. Le të përgatitet Arsim Bajrami.

GANI BUÇINCA: I nderuari, zoti Kryetar!

Të nderuar ministra të Kabinetit qeveritar dhe kolegë deputetë,

Dëgjova me vëmendje debatin dhe, t'ju them të drejtën, jam mjaft i shqetësuar.

Debati, i cili po zhvillohet sot në këtë Kuvend, nuk është racional në kuptimin e gjetjeve të zgjidhjeve praktike për të kursyer paratë e taksapaguesve të Kosovës. Më shumë ka nostalgji dhe ka emocione. Pavarësisht se disa nga kolegët e nderuar këtu, që mundohen ta prezantojnë këtë si interes publik prolongimin e renovimit të Pallatit të Shtypit dhe

vendosjen e disa ministrive në këtë objekt, mund t'ju them se karakteri i debatit kishte krejt kontekst politik dhe kontekst pozitiv – opozitiv.

Unë në diskutimin tim do të përqendrohem në arsyeshmërinë e këtij propozimi të Qeverisë, në arsyeshmërinë ekonomike dhe praktike që ka të bëjë me funksionimin e Qeverisë, të institucioneve qeveritare dhe kursimin e parave të taksapaguesve kosovarë.

Mund t'ju them se dëmi nga anulimi i tenderit për meremetimin e Pallatit të Shtypit deri më tani ka qenë rreth 15 milion euro. Në rast se ne nuk e rinovojmë këtë ndërtesë së shpejti dhe t'i akomodojmë institucionet e Kosovës aty, dëmi do të jetë sigurisht edhe një dy-tri herë më i madh.

Investimet në kompleksin qeveritar, që gjithsesi do të jenë shumë të mira, nuk sigurojnë një akomodim të shpejtë të institucioneve të Kosovës dhe qiraja që do të paguhet përderisa përfundon kompleksi qeveritar, që është një kompleks strategjik dhe unë e përkrah dhe është ide shumë e mirë, por e parealizueshme për momentin, dëmet do të jenë aq të mëdha dhe taksapaguesit e Kosovës do të jenë të detyruar të paguajnë edhe shumë para për xhepa të qiradhënësve në Kosovë.

Unë nuk do të hyj në kontekstin pronësor të këtij objekti, për arsye se konteksti pronësor ka mundësi të zgjidhet me bazën ekzistuese ligjore që ekziston në Kosovë dhe nuk është ky objekt plotësisht objekt shoqëror. Është mikst dhe në bazë të legjislacionit aktual mundet shumë lehtë që, me vendim të Kuvendit, këtij objekti t'i ndërrohet edhe destinacioni. Por, edhe sikur të ishte objekt shoqëror dhe sikur të ekzistonte baza ligjore 100% për privatizimin e tij, unë mendoj se shumë më shumë do të kursejë Qeveria e Kosovës para në rast se i destinon këto para për renovimin e objektit se sa të vazhdohet edhe katër vjet ose edhe pesë vjet tjera për të përfunduar një projekt tjetër dhe të paguhet qira për objekte. Pavarësisht se kush do ta marrë këtë objekt, megjithatë ato investime do të mbesin në Kosovë dhe dëmi ekonomik do të jetë shumë më i vogël dhe taksapaguesit e Kosovës do të paguajnë më pak për këto qëllime.

Unë propozoj që të formohet një komision parlamentar dhe të hetojë tërë problemin e objektit të pallatit të "Rilindjes"...

KRYETARI: Nuk është kjo në rend dite, të lutem!

GANI BUÇINCA: ... dhe të ndahet procedura e alokimit të mjeteve me procedurat tjera, të cilat edhe ashtu janë duke rrjedhur në gjykata. Unë e kuptoj opozitën aktuale që ka qenë në qeveri dhe që ka hezitime për këtë projekt, mirëpo nuk mund të kuptoj ata deputetë të cilët dëshirojnë që Qeveria e Kosovës të vazhdojë kontinuitetin e keqqeverisjes së qeverisë së kaluar. Unë jam për të vazhduar kontinuitetin aty ku ka pasur kontinuitet, ka pasur qeverisje pozitive, ka pasur projekte pozitive, por jo të vazhdohet kontinuiteti i keqqeverisjes edhe në këtë Qeveri. Zoti Baliq, askund në botë, një qeveri nuk mund të vazhdojë me praktikën e gabuar të qeverisë së kaluar, se nuk ka edhe qeveri të pagabueshme. Unë jam i bindur se edhe kjo Qeveri mund të bëjë gabime, por duhet së paku që qeveria që vjen pas, të bëjë përpjekje që t'i përmirësojë disa gabime që janë edhe njerëzore.

Unë ju lus, të nderuar deputetë këtu, dhe besoj se brenda këtij Kuvendi ka aq përgjegjësi politike dhe aq moral politik sa që ky projekt të votohet dhe të shkojmë përpara dhe projektet kapitale strategjike që i duhen Kosovës edhe për praktikë qeverisjeje, por edhe për prestigj si shtet, t'i lëmë për më vonë, në kohë pak më të mira. Ju faleminderit!

KRYETARI: Për replikë, Numan Baliqi, është lajmëruar, sepse ia ke përmendur emrin!

NUMAN BALIĆ: Faleminderit, zoti Kryetar!

Ja, naravno, nisam imao najmanju želju da polemiziram sa bilo kim i malo mi je nejasno zašto je gospodin Bućinca poželio da polemiziramo. Ali, moji stavovi, vezano za Vladu, nemaju nikakvu vezu sa raportom odnosom pozicija – opozicija, niti sam bio učesnik u prethodnoj, niti u ovoj Vladi. Moj stav je polazio od toga da nije dobro da postoje potpuno dijametralno suprotni odnosi prema tako važnim pitanjima i govorio sam o zaokretima koji se mogu napraviti, ali nije moguće da odnosi budu crno-bijelo, dakle da odnosi budu sto po sto različiti, ili suprotni. To je bila glavnina moje zamisli u vezi s ovim. Naravno, mislim da gospodin Bućinca baš ne mora da bude advokat ove vlade ili protivnik one prethodne. Mislim da nema potrebe, apsolutno!

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka Arsim Bajrami, le të përgatitet Vezira Emrush.

ARSIM BAJRAMI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Do t'i sqaroj tri fakte parimore, sepse deputeti Rugova tha se nuk ka informacione të nevojshme.

Fillimisht, ne e dimë që kjo Qeveri ka trashëguar një gjendje kaotike sa u përket institucioneve. Po ju jap vetëm një fakt, mbi 60% e institucioneve të Republikës së Kosovës janë në objekte private. Është një fakt që duhet të gjithëve të na shqetësojë sepse tani jemi shtet dhe domosdoshmërisht edhe objektet edhe standardet e objekteve janë një pamje e shtetit, e nuk po të flas tash për standardet dhe kushtet teknike që ofrojnë shtëpitë private për punë të institucioneve.

Fakti i parë, që dua ta sqaroj, e që e ngriti shefi i Grupit Parlamentar të LDK-së, është rreth Kompleksit qeveritar.

Dëshiroj të theksoj se Qeveria e Republikës së Kosovës nuk ka hequr dorë nga ndërtimi i Kompleksit qeveritar, përkundrazi ka intensifikuar punimet dhe, ky projekt, edhe po të fillojë sot, do të përfundojë në vitin 2015 me dinamikën e paraparë, zoti Maloku, me dinamikën e paraparë të cilën Qeveria e ka marrë na Qeveria e kaluar, parashihet që projekti të përfundojë në vitin 2015 dhe për këtë qëllim Qeveria ka bërë një agjendë të mjeteve buxhetore rreth 90 milion të mjeteve ka paraparë që çdo vit të ndahen nga 8 deri 10 milion për të ndërtuar. Dhe, po të fillojmë sot të ndërtojmë, kompleksi do të jetë i gatshëm deri në vitin 2015. A do të pajtohemi që deri në vitin 2015 si shtet sovran dhe i pavarur të funksionojmë nëpër shtëpi private, në lagje të ndryshme të Prishtinës, pa infrastrukturë, pa kushte teknike? Për këtë qëllim, Qeveria ka prur planin strategjik, e cila parasheh që në faza të akomodohen institucionet në objekte shtetërore dhe publike. Zoti Koci, shumë mirë e sqaroi bazën legale. Prej 15 të këtij muaji, Republika e Kosovës është përgjegjëse, pronare për pronën publike, për pronën shoqërore dhe ajo do të vendosë dinamikën e privatizimit përmes Agjencisë për Privatizim. Kështu që, ne duhet ta kemi të qartë se nuk është më OKB, nuk është më UNMIK-u, nuk është më AKM që të

disponojnë me pronën publike, sepse po të ishte kështu, atëherë edhe gjysma e institucioneve që sot i kemi në ndërmarrje publike do të duhej të ishin në shtëpi private. Është në vlerësimin politik të deputetëve a dëshirojnë që deri në vitin 2015 të kemi këtë gjendje kaotike të objekteve, apo dëshirojnë të bëjnë atë që është e mundshme. Ajo që është e mundshme, është propozuar me këtë që përkohësisht të merren disa objekte publike, të cilat edhe ashtu po shkatërrohen, që është pronë e qytetarëve të Kosovës, këtë e tha edhe zoti Hajdari shumë mirë, është pronë e shtetit të Kosovës, a t'i lëmë të shkatërrohen, apo t'i marrim dhe në ato institucione dalëngadalë t'i vendosim ministrinë tona, duke ndalë këtë qarkun e qirave të dyshimta që po gëlltisnin mjete të konsiderueshme, si një fazë kalimtare, e cila do të na çojë drejt atij Kompleksi qeveritar. Interes strategjik i Qeverisë së Republikës së Kosovës është Kompleksi qeveritar. Mirëpo, pse s'është filluar menjëherë, është faji te komunat, nuk faji te komuna e Prishtinës, por janë arsyet objektive. Komuna e Prishtinës ende nuk e ka përfunduar aparatin kadastral, fotografimin dhe punët e nevojshme. Unë kam takuar mbi pesë herë kryetarin e Komunës dhe i ka kuptuar shkaqet objektive pse ai nuk ka mund qysh tash të na japë pozicionin, hapësirën në lagjen e Hajvalisë në mënyrë që ne të fillojmë menjëherë të ndërtojmë.

Kjo nuk do të thotë se Qeveria heq dorë. Ne dëshirojmë sa më shpejt, ndoshta edhe në vjeshtë të kemi këtë punë të kryer nga komuna e Prishtinës dhe të fillojmë implementimin e Kompleksit qeveritar, i cili është rekomanduar edhe si prioritet i shkallës së parë edhe në Konferencën e Donatorëve.

Sa i përket kontestit gjyqësor, nuk është objekti në kontest gjyqësor. Në kontest gjyqësor është një kompani, e cila i ka ndalë punimet me vendimet e qeverisë së kaluar. Unë i kam dy vendimet, e kam vendimin edhe të ish-kryeministrit dhe vendimin e ministreshës dhe unë e kuptoj se ndoshta AKM-ja atëherë ka kërkuar të ndalen punimet, por tash AKM nuk ka. Në qoftë se deri tash kemi pasur alibi për AKM-në, tani s'e kemi atë problem, kështu që ne duhet ta vlerësojmë a është më mirë të gjejmë zgjidhje, duke adaptuar këto objekte publike që janë pronë e Republikës së Kosovës dhe duke i futur në funksion qeveritar përkohësisht, apo të vazhdojmë deri në vitin 2015 me këtë gjendje kaotike të funksionimit të institucioneve nëpër shtëpi private.

Edhe vetë ju e dini që tani, kur jemi shtet sovran dhe i pavarur, ka shumë rëndësi se ku priten zyrtarët. Priten në një godinë publike, e cila nuk është privatizuar, apo duhet t'i dërgojmë nëpër lagje periferike të Prishtinës dhe atje t'iu organizojmë pritje.

Për këtë arsye, është kërkuar ky ridestininim i mjeteve buxhetore. Nuk është vetëm pallati "Rilindja" sepse ne jemi duke përgatitur edhe disa objekte tjera, të zbrazura, që janë duke u shkatërruar dhe disa objekte tjera Qeveria i ka marrë në shfrytëzim dhe është duke i mbrojtur nga uzurpimet e mundshme, të individëve, sepse ato janë në një gjendje tash transitore ku AKM-ja i ka lëshuar nga kontrolli, nuk i ka në kontroll dhe ekziston mundësia e uzurpimit të tyre, prandaj Qeveria i ka marrë në kontroll dhe ato do t'i adaptojë dhe do t'i vendosë një nga një.

Qeveria ka marrë zotim që deri në fund të vitit të gjitha institucionet të vendosen në objekte publike dhe Qeveria do të arrijë ta realizojë këtë vetëm me mbështetje të Kuvendit dhe me mirëkuptim që është interes strategjik i Republikës së Kosovës që ky

proces të përmbyllet sepse është jashtëzakonisht e rëndësishme se çfarë performance tani po krijojmë si shtet sovran dhe i pavarur. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka deputetja Vezira Emrush, le të përgatitet deputeti Ibrahim Makolli.

VEZIRA EMRUŠ: Ovako, ja bih srdačno pozdravila sve prisutne ovde, kolege i Predsedništvo,

Nisam htela da se javim na ovu tačku, ali debata je jako korisna danas. Prvo, mi moramo da znamo ko smo i šta smo. Vlada, kao Vlada, ima zakonodavnu moć, a sudovi imaju izvršnu moć. Ovde su se pomešali pojmovi kada je u pitanju zgrada „Rilindje“ – svojinski pojmovi. Zgrada „Rilindja“ je javno preduzeće i prelazi u nadležnost Vlade a ne u vlasništvo Vlade. Znači, nagleda Vlada, zato što su to, kao što je gospodin kolega rekao „mikst“ i taj mi se izraz svidjao – „mikst“ preduzeća. To su, u stari, institucije društvene i državne. Vlada ne može da uzme ono što je društveno. Zna se kakva je preraspodela kapitala – 51:49, to je u okruženju, to je u međunarodnom sudu, a ako mi sada počnemo da preuzimamo sve društvene imovine i da renoviramo, a moramo da se spremamo za prodaju, za privatni kapital, i ako tako trošimo pare, mi kao vlada, vlada danas treba da štedi a ne da troši nepotrebno pare. Ne smemo da ulažemo u ono što nije čisto vladino. Treba dobro da pročitamo Ahtisarijev plan, treba dobro da znamo u okruženju zakone. Meni je žao što to ne mogu po članu i po stavu da kažem, jer mi nije u profesiji, ali da li je korisno, kao što je gospodin ministar rekao, slušala sam ga, da je to strateški plan za Vladu. Nije strateški plan za Vladu jedna zgrada, gde će da se smeste, da kažem 400 – 500 ljudi. Strateški je plan za sve nas kako ćemo da zbrinemo 2 miliona ljudi. Moramo da pazimo i da merimo korake gde trošimo, dobro da se analizira, da se napravi matematika šta se dobija, šta se gubi. Toliko! Hvala!

KRYETARI: Faleminderit! Për fjalë është paraqitur diskutuesi, i fundit, Ibrahim Makolli.

IBRAHIM MAKOLLI: Faleminderit, zoti Kryetar!

(Ndërprerje e shkurtër e incizimit)

KRYETARI: Faleminderit shumë! Ju e dini që vetëm një herë deputeti ka të drejtë për diskutim. Ju e keni krye fjalën tuaj, edhe Ardian Gjini, dhe ju lus, tash fjalën e ka Ibrahim Makolli.

(Ndërhyrje)

IBRAHIM MAKOLLI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë,

Ne i kemi hequr nga rendi i ditës dy pika, për shkak të mungesës së sponzoruesve, në këtë rast, të ministrave. Po të njëjtën çështje e kemi edhe këtë, të cilën po e debatojmë. Kërkesa ka ardhur nga ministri për Ekonomi e Financa, zoti Ahmet Shala, i cili, sot, nuk është këtu, prandaj do të ishte mirë që këtë çështje ta zhvendosim për një seancë tjetër duke mirëkuptuar të gjitha ato që u thanë deri tash.

(Ndërhyrje)

Absolutisht, nuk do të pajtohesha me faktin që tashmë ka përpjekje të përplasjeve brenda këtu me akuza se kush ose cili ka prirë që më shumë të jetë në pjesë ku sot janë të vendosura institucionet e Kosovës dhe të mos harrojmë se që nga qeveria e parë, kur edhe ju, që tash jeni pjesë e koalicionit ose udhëheqje e Qeverisë, keni marrë pjesë në vendosjen e institucioneve të Kosovës në objekte private, e cila ka vazhduar deri tash.

Natyrisht, Qeveria, me vendime të veçanta mund t'ua ndërrojë destinacionin objekteve të caktuara dhe duhet ta sjellë një gjë të tillë para se ne të marrim vendim për ose kundër kësaj. Jo rrallëherë ka ndodhur që institucionet e Kosovës, Qeveria e Kosovës, por edhe Kuvendi të investojë ose të bëjë investime të dyshimta sikur që tash kemi dy çështje, edhe Qendrën në Gërmë, edhe këtë objekt qeveritar, prandaj përderisa Qeveria të mos sjellë edhe kopjen e pronarit të kësaj ndërtese, gjithsesi do të deklarohejmë kundër miratimit të një kërkesë të tillë nga ana e ministrit për Ekonomi dhe Financa. Faleminderit!

KRYETARI: E ke pasur fjalën. Urdhëro, merre fjalën. E ka fjalën deputeti Berim Ramosaj.

BERIM RAMOSAJ: Shikoni, së pari, të sqarohem, zoti Kryetar, të jeni më korrekt në dhënien e fjalëve, sepse atëherë e kam pasur fjalën si përfaqësues i LDD-së dhe ma keni përmendur emrin, kam pasur të drejtë edhe në replikë.

KRYETARI: Po mirë, ta dhashë fjalën, tash fol!

BERIM RAMOSAJ: Këtë po e them në mënyrë shumë të sinqertë. Nëse ke probleme për të mbajtur në mend, ai është problem yti, nuk është i imi. Më fal! Kërkoj vetëm të jemi korrektë!

Sa i përket çështjes së alokimit të mjeteve, edhe një herë dëshiroj t'ua bëj me dije edhe pozitës edhe deputetëve të nderuar kolegë këtu, edhe qytetarëve që janë duke na shikuar ndoshta drejtpërdrejt, se opozita dhe Berim Ramosaj nuk është kundër që Qeveria të gjejë objekte publike apo të vendoset në objekte publike, sepse kërkesa juaj, kërkesa e zotit Hashim Thaçi që të barten krejt ministritë nga shtëpitë private në institucione publike ka qenë e përkrahur edhe nga ana jonë dhe i jemi gëzuar shumë asaj kërkesë. Bile, kemi pritur deri tash, që të vendoseni edhe më herët. Por, kërkesa jonë është shumë principiele. Në qoftë se vërtet dëshironi të zgjidhni problemin e institucioneve të Kosovës, të institucioneve qendrore, ju lutem, sqaroheni çështjen e titullarit, mos hudhni mjete. Ju mund t'i hudhni aty mjetet, nesër e pasnesër mund të privatizohet ai objekt.

Sa për sqarim. Edhe Ministria ku është profesori i nderuar Bajrami, edhe ajo Ministri është në objektin që nuk e ka të zgjidhur çështjen e titullarit e që edhe ajo më vonë mund të privatizohet. Ju lutem, të jemi shumë korrektë. Dhe këto mjete, që po thoni, nuk janë të Ministrisë. Këto janë taksa të qytetarëve të Kosovës që ne kemi obligim shumë të madh të dimë ku po i hudhni. Ne jemi shumë, shumë të interesuar që vërtet institucionet e Republikës së Kosovës të vendosen në institucione të qëndrueshme publike e jo në private. Në këtë variant, në qoftë se dëshironi të rinovoni objekte që nuk e kanë të sqaruar çështjen e pronësisë, unë mendoj vetëm e zhagitni procesin.

E tash, sa për replikë, të asaj që më the më herët, si profesor i ekonomisë, po të them: Nëse ke intencë për të mësuar diçka nga ekonomia, unë mund ta angazhoj një asistent, të mbanë leksione. E, se a kemi të drejtë, a s'kemi të drejtë, ajo është çështje e dorës së dytë. Të mirëkuptohemi, ju lutem!

KRYTARI: Fjalën e kam unë, si deputet.

Unë, së pari dua të them se s'kam nevojë për këshilla tua as profesionale, sepse, në rend të parë, je i paedukuar.

Prandaj, do të duhej të ishe më i mirësjellshëm, sepse s'ke pasur të drejtë ta marrësh fjalën, e megjithatë ta kam dhënë fjalën.

Edhe unë, për hir të qytetarëve dhe për hir të tatimpaguesve, dua t'i them vetëm disa fjalë për atë se sa mjete janë shpenzuar nga mjetet e tatimpaguesve të Kosovës për ndërtesën, për të cilën po flasim. Ndërtesa ka qenë e paraparë, me vendim të veçantë, fillimisht të shefit të UNMIK-ut për t'u riparuar dhe për t'u bërë ndërtesë e Qeverisë së Kosovës. Për këtë edhe janë larguar mediat, ju e dini. Ne s'i kemi larguar, i ka larguar administrata e UNMIK-ut.

E dyta. Për pastrimin e objektit në fjalë, nga Buxheti i konsoliduar i Kosovës, paratë e tatimpaguesve të Kosovës janë dhënë mbi 1 milionë euro. Në një tender që ka qenë i përgatitur, para se unë të bëhem ministër në qeverinë e parë, ka qenë e dhënë për projektuesin të jepen 2 milionë euro. Ne e kemi prishur atë dhe Qeveria e Kosovës, për projektuesin ka harxhuar 1 milion euro. Do të thotë 50% apo 100% më lirë.

Tjetra. Në tenderin, që e ka fituar Ndërmarrja ndërtimore "Çlirimi", e që është prishur në mënyrë të parregullt nga kryeministri i parë i legjislaturës së dytë, me një marrëveshje në mes punëkryerësit dhe Minsitrisë, Buxheti i konsoliduar të Kosovës i ka dhënë punëkryerësit 760 mijë e diçka euro. Do të thotë, deri këtu u harxhuan 2.760.000 euro. Kur e llogarisim se ndërmarrja në fjalë e ka fituar gjyqin e shkallës së parë, që dënimi nuk do të jetë më pak se 3 milion euro, por mbi – rumbullakësisht Buxheti i konsoliduar i Kosovës, në këtë objekt është dëmtuar mbi 6 milion euro. Kur llogarisim qiradhëniet nga buxheti i konsoliduar i Kosovës, që janë me mijëra euro në vit, bile janë tash diku 5 milion euro, do të thotë bëjnë diku mbi 11 milion euro. Do të thotë, deri më tani, pasi po i mbroni qytetarët e Kosovës, unë jam i obliguar të them se vetëm për atë objekt e për qiradhënie, qytetarët e Kosovës janë dëmtuar për më shumë se 11 milion euro.

Prandaj, nuk është mirë, nuk është mirë të luajmë në emër të qytetarëve, në emër të mbrojtjes së parasë publike ku nëse, vërtet, shtyhet kjo kërkesë e Qeverisë, do të ketë miliona euro shtesë për çdo qira për objektet që janë të paligjshme, që nuk kanë as leje ndërtimore dhe institucionet e Kosovës – të Qeverisë së Kosovës – janë të vendosura në ato objekte, mendoj se shuma është marramendëse.

Unë, si deputet dola për t'ju treguar se qytetarët e Kosovës dhe buxheti i Kosovës deri më tani për parregullsitë ka humbur miliona euro.

Sa i përket kontestit, ju lutem, u tha, janë miratuar ligjet, por unë bile kam menduar se sot, nga opozita do të dalë një kërkesë për të formuar një komision hetimor për t'i hetuar

të gjitha procedurat që lidhen me ndërtesën e ish “Rilindjes”. Kjo do të ishte një kërkesë për mua shumë e arsyeshme e opozitës.

Prandaj, ju lutem, unë megjithëkëtë, s’dola t’ua ndryshojë mendimin për të votuar “për” ose “kundër”, sepse kërkesa nuk është e imja, është si është për secilin prej jush, është edhe për mua. Kërkesa është e Qeverisë. Megjithatë, deputetët, edhe të pozitës, edhe të opozitës, t’i kanë parasysh detyrat dhe përgjegjësitë që i kanë marrë para qytetarëve. Ju faleminderit!

(Ndërprerje e incizimit)

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Ardian Gjini.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Mendoj se këtu janë disa çështje paraprake dhe mendoj se me kredibilitet i keni udhëhequr të gjitha mbledhjet e Kuvendit deri më tash, e them me bindje të plotë dhe me sinqeritet më të madhin dhe jam i bindur se do të vazhdojë kështu edhe në të ardhmen. E kemi një shpresë kur e udhëhiqni ju Kuvendin dhe prapë e them me bindjen më të madhe. Shpresoj se do të vazhdohet gjithmonë kështu.

Çështja tjetër, për të cilën do të flas, kthehet te tema. Me të vërtetë duhet pasur moral politik. Dikush e përmendi këtu, nuk po e them për replikë, pajtohem plotësisht: Kuvendi duhet të ketë guxim të thotë çka dinë të gjithë, edhe zogjtë. Po kërkoj prej Kuvendi që të thirren në atë sinqeritet.

Çështjet të cilat i përmendëm ne janë plotësisht parimore, nuk kanë të bëjnë me asgjë e cila dikujt mund t’i duket vetëm si çështje e opozitës dhe secili le ta thërret vetveten për atë që e di, para se të thotë diçka.

Dy çështje mund të ndodhin, nëse ne sot e votojmë këtë propozim të Qeverisë. Ose, përmbi të gjitha, ato të cilat i thatë ju, zoti Kryetar, si humbje që janë evidente, ndoshta për gjysmë, sepse nuk është dënuar ende, dhe nuk është ai 3 milionëshi. Mbi të gjitha ato, do të humbin edhe këto 7,5, për shkak se objekti nuk është i Qeverisë. Nuk guxon të ngatërrohet prona publike me pronën shoqërore. Punëtorët e ndërmarrjes “Rilindja” janë po ashtu aksionarë në këtë pronë, të gjithë ata punëtorë. Do të thotë, nuk është e Qeverisë, është ndërmarrje shoqërore, nuk është ndërmarrje publike. Sikur të ishte publike, ky debat nuk do të ishte zhvilluar. Nëse eventualisht, prapë, nuk humbin disi paret, këto mjete, domethënë nëse nuk ndodh që 7,5 milion duhet të privatizohen pa u llogaritur investimet, atëherë definitivisht se do të ndodhë një dëm edhe më i madh, e ai dëm do të jetë se do të duhej dikush ta ndikojë gjykatën për të marrë vendim në favor të Qeverisë ose të Kuvendit.

Çështja tjetër është ajo që e tha ministri. Ministri tha, a dëshironi ju deri në vitin 2015 të paguhet qira. Zoti ministër, me gjithë respektin, prapë. Është një grim manipulim këtu me një të vërtetë, për shkak se ju vetë thatë, në paraqitjen e parë tuajën, që ka objekte të cilat i shfrytëzon UNMIK-u, ka objekte publike në të cilat do të barten disa institucione të Kosovës të cilat ekzistojnë sot. Do të thotë, nëse kjo bartje bëhet, ajo humbje, për të cilën po flisni ju deri në vitin 2015, nuk do të ndodhë. Ato mund të jenë të përkohshme, por në to nuk do të paguhet qira, shembull ta marrim.

Çështja tjetër është se, nëse fillohet me ndërtimin e Kompleksit qeveritar, është e vërtetë se përfundimi do të vjen në vitin 2015, por jo i tërë ndërtimi –përfundon në vitin 2015. Ka faza në atë plan dhe mund të ndodhë që në fillim të vitit të ardhshëm ose në mes të vitit të ardhshëm vetëm ta kemi një pjesë dhe të përfundojmë me qira. Do të thotë, nuk mund të themi se, nëse nuk e rinovojmë këtë objekt, deri në vitin 2015 do të paguajmë qira. Thjeshtë, nuk është e vërtetë. Nuk është e vërtetë për shkak se ky objekt nuk i zgjidhë të gjitha nevojat e Qeverisë, të cilat ne i dimë, e thatë edhe ju vetë, njerëzit janë me qira.

Dhe, e fundit. Ligji për menaxhimin e ndërmarrjeve publike nuk është ligj për menaxhimin e ndërmarrjeve shoqërore. Titulli i Ligjit, është Ligji për menaxhimin e ndërmarrjeve publike, jo Ligji për menaxhimin e ndërmarrjeve publike dhe shoqërore. Ndërmarrjet shoqërore, pronën dhe asetet e atyre ndërmarrjeve nuk i menaxhon Qeveria e Kosovës, as tash e tutje. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Përpara e kam Ligjin për ndërmarrjet publike. Te neni 3, pronësia – shkruan: “Paragrafi 3.1. Të gjitha ndërmarrjet e radhitura në listën 1, e cila i është bashkëngjitur këtij ligji, janë ndërmarrjet publike qendrore. Të gjitha ndërmarrjet publike qendrore janë në pronësi të Republikës së Kosovës”. Ligji është miratuar dhe ka hyrë në fuqi më 15 qershor të këtij viti.

(Ndërhyrje e deputetëve)

Faleminderit! Vazhdojmë me debat. Unë, e lexova ligjin, tash vazhdojmë. E ka fjalën deputetja Melihate Tërmkolli.

Gani, dhe deputetë të tjerë, ju lutem ta kërkonin fjalën dhe e merrni fjalën. Kur ta merrni fjalën, vazhdoni të flisni. Urdhëroni deputete!

MELIHATE TËRMKOLLI: Faleminderit!

Të them të drejtën, s’pata ndërmend të diskutoj, por po më duket është e arsyeshme dhe po e shoh të nevojshme t’i them dy-tri fjalë rreth kësaj çështjeje. Së pari, kjo nuk është çështje procedurale, siç u bë përpjekje të paraqitet. Është çështje e ndryshimit të politikave, të cilat i ka miratuar Kuvendi i Kosovës para pak kohësh, kur e ka miratuar edhe buxhetin e Kosovës. Prandaj, le të hiqet nga fjalori se është një çështje procedurale. Do të thotë, është çështje e ndryshimit të një projekti dhe të një politike që lidhet me një çështje shumë të rëndësishme.

Mua më vjen keq që këtu po manipulohet shumë me fjalë, me të dhëna dhe me realitete, që nuk është mirë, as nga ministrat, as nga disa deputetë sikur po bëhet këtu, sepse, në fund të fundit, ndoshta është një pjesë që është shumë fillestare, por është një pjesë e madhe e deputetëve që i njohin mirë rrjedhat sepse janë një kohë të gjatë në punët dhe aktivitetet e tyre këtu.

Mund të them së pari që ato që u diskutuan, ndoshta edhe s’është mirë të përsëriten. Çështja e pronësisë është çështje esenciale dhe elementare dhe nuk mundet Qeveria aktuale të nxirret me faktin e miratimit të ligjit tash rreth çështjes së pronësisë. Mua më erdh keq, kur ministri thotë se Qeveria vendosë për dinamikën e privatizimit, e tjera. Pajtohem se mund të vendosë tash për dinamikën e privatizimit, por Qeveria nuk guxon

të vendosë për ndryshimin e pronësisë. Qeveria nuk e ka këtë të drejtë, përveç nëse nuk lejon të funksionojë qysh kanë funksionuar një pjesë e madhe e tyre me uzurpime private dhe të ngrihet kjo në nivel të politikës shtetërore. Kjo është e papranueshme!

Më falni, ju e dini shumë mirë, një pjesë e madhe e njerëzve tuaj partiak, emrat e tyre janë të lidhur me uzurpime të mëdha të pronave, por kjo të ngritët në nivel të politikës shtetërore, është katastrofale për këtë vend. Kjo do të thotë legjitimim i plotë i një politike diktatoriale që kishin për t'ia pasur lakmi edhe vendet tjera. Unë mendoj se kjo nuk duhet të funksionojë. Domethënë, pronësia e këtij objekti, mbetet e pasqaruar. Unë kam dokumentin ku AKM-ja, të cilën e ka udhëhequr zoti Ahmet Shala, që më vjen keq, nuk është këtu, e të cilin kjo parti tash e ka marrë dhe e ka bërë ministër për ta vazhduar atë politikë që e ka bërë në AKM. Do të thotë, ma kanë sjellë letrën, në të cilën thuhet se “Qeveria e merr rrezikun për këtë objekt dhe për investimet që i bën në këtë objekt. AKM lirohet nga çdo rrezik lidhur me këtë objekt, në rast dhe në kohën kur do të bëhet shitja e këtij objekti”. Unë, do t’ua sjell atë letër, zotëri! Nuk e kam prurë sot, sepse kjo hyri kështu si për një temë që jam njoftuar pak më vonë.

AKM! Dhe, nëse kjo AKM ka kute tjera, për kohën kur në qeveri janë disa subjekte tjera dhe kute krejt tjera, në kohën kur Hashim Thaçi e udhëheq këtë Qeveri, atëherë mjerë për këtë milet! Mjerë për këtë milet kush e qeveris! Është e rëndë. Më falni, por kështu është.

KRYETARI: Të lutem, nuk është temë për emrin e përveçëm.

MELIHATE TËRMKOLLI: Një çështje tjetër! Një çështje, që lidhet me humbje, zotëri që ju i thatë këtu. Është shumë e vërtetë se Qeveria e kaluar ka marrë vendimin sepse ajo qeveri ka menduar për një kohë afatgjatë dhe për gjëra të sigurta. Nuk mund të ndërtohet politika e shtetit dhe politika e qeverisë ad-hoc. Politika e shtetit ka një afat, ka një qasje afatgjate të zgjidhjes së problemeve dhe politika e shtetit nuk mund të hyjë në gjëra të cilat nuk janë të sqaruara si duhet. Nuk mund të hyjë në prona, të cilat nuk e kanë të sigurt titullarin që quhet qeveri, ose që quhet publike, e që tash këtu po mundohet ta ngatërrojë me atë shoqërore, e tjera – e tjera, që gjëja, ligji po e lejonte atje.

Prandaj, qeveria e ka bërë një plan, i cili, vërtet është pak më afatgjatë, por që është shumë i sigurt dhe asnjëherë mua komuna nuk më ka thënë për Hajvalinë atje se nuk na japin lejen. Ata kanë thënë se për këtu nuk e japim lejen, një pjesë që është afër “Rilindjes”, por jo për atje. Prandaj, kjo arsye nuk qëndron. Më vjen keq, por nuk qëndron. Është keq që të sillet ministri me këto. Ndoshta edhe këta e kanë ndërrua, ndoshta edhe këta tash kanë thënë se nuk e lejojnë.

Për humbjet, është shumë e vërtetë dhe unë pajtohem se absolutisht këto të qiten dhe të dihet se kush e mban përgjegjësinë për këto humbje. Sepse, nëse dikush ka shti mjete 2 milion dhe ka bërë kontratën edhe për 4 milion tjera, në një objekt, i cili e ka dike tjetër titullar dhe rrezikun e të cilës e merr qeveria, në rast të shitjes, atëherë unë kërkoj që absolutisht të kërkohet përgjegjësi kush e ka bërë këtë. Dhe, kjo përgjegjësi – kjo përgjegjësi iu takon atyre që e thanë tash. I takon udhëheqjes së PDK-së, ministrat e së cilës kanë qenë në atë kohë në qeverinë e Kosovës. Njësoj, edhe e kryeministrit. Kjo është politikë, të cilën e kanë bërë. Dhe, në përpjekje për të ndalë një zhvillim të tillë të politikës janë menjëherë reagimet për ta rikthyer atë politikë. Unë mendoj se rikthimi i politikës dhe investimi në objekte të dështuara, në objekte të cilat edhe me i pa janë

katastrofale e lëre më për të hyrë e për të punuar në to, plus mjetet jashtëzakonisht të mëdha, të cilat kërkohen, kujtoj është një politikë e mbrapsht, është një politikë që nuk i bën nder Kosovës, është një politikë që nuk u bën nder atyre që po japin para për investime publike e tjera.

Dhe, krejt në fund, unë do të them se këto çështje, të cilat u trajtuan sot këtu, në fakt edhe të gjitha këto fakte dhe argumente të cilat u paraqitën, le të shqyrtohen dhe le të trajtohen. Qeveria le t'i rikthehet – le t'i rikthehet asaj që e ka miratuar Kuvendi i Kosovës. Nuk mundet Kuvendi i Kosovës përditë të marrë vendime ndryshe për politikën dhe vendimet të cilat i ka miratuar më herët dhe kjo lidhet pra me ndryshim të politikës dhe në këtë drejtim nuk do të dëshiroja që para këtij Kuvendi të paraqiten më veprime të tilla dhe gjëra të tilla.

U tha se për objekte po jepen mjete. Është shumë e vërtetë. Janë dhënë edhe në qeverinë e parë. Janë dhënë edhe në qeverinë e dytë mjete për objekte private e tjera. Është shumë e dhembshme ajo që po ndodh, por lëvdata e sotme e Qeverisë se ka bërë ndryshime dhe po bën ndryshime për një rrethanë objektive që nuk lidhet me punën e saj absolutisht, por lidhet me shkuarjen e UNMIK-ut, është shumë e ligë, është shumë e papranueshme. Nuk është se ajo qeveri nuk paska dashtë t'i sistemojë ministrinë nëpër objekte publike. Është shumë e ulët nëse thuhet se ajo qeveri s'paska dashtë e tash kjo qeveri po donë t'i sistemojë. Por nëse ka ndodhur një rrethanë objektive, që nuk lidhet hiq me punën e kësaj qeverie, atëherë duhet të thuhet dhe të thuhet në mënyrë të sinqertë dhe kjo nuk po ndodhë. Fatkeqësisht, s'po ndodhë.

Prandaj, unë me shumë respekt për të gjithë, por mendoj kjo çështje duhet të përmyllet në kuptim të asaj se nuk mundet Parlamenti t'i ndryshojë politikën për çdo ditë, prandaj Qeveria të mendojë seriozisht për zbatimin e atij projekti që e ka miratuar Parlamenti i Kosovës për Komplexin e objekteve qeveritare. Faleminderit!

KRYETARI: Lus deputetët që të jenë të lidhur me temën. Fjalën e ka Lulzim Zeneli. Le të përgatitet Synavere Rysa.

LULZIM ZENELI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Pas asaj që theksoi parafolësja, më mbetet shumë pak të them diçka më tutje, por vetëm një gjë do ta specifikoj. Atë qasjen, çfarë e demonstroi ministri i Shërbimeve Publike dhe me këtë qasje çfarë po demonstroi edhe Qeveria në përgjithësi, në këtë formë të trajtimit të pronës shoqërore, kjo mund të ndodhë, por mund të ndodhë vetëm me një kusht: në qoftë se ndryshon sistemi politik i vendit – i Kosovës, të ndryshojë Kushtetuta e Kosovës. Në këtë formë të trajtohet prona shoqërore dhe të thirremi në një ligj i cili për menaxhimin e ndërmarrjeve publike, për diçka që edhe Kryetari i Kuvendit, që është parë shumë qartë dhe në mënyrë decitive, nuk përmend as nuk e trajton këtë çështje. Prandaj, investimi në një rrugë që nuk çon as në realizimin e politikave shtetërore, as në realizimin e prioriteteve qeveritare, për ne – si deputetë – duhet të jetë e papranueshme.

Prandaj, pa hyrë në detaje, sepse është thënë këtu në mënyrë decitive dhe të qartë, si Grup Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Dardanisë e kundërshtojmë fuqishëm një qasje të tillë dhe kjo qasje e kjo politikë nuk i bën nder as këtij Kuvendi, as shoqërisë, në përgjithësi. Faleminderit!

KRYETARI: Kërkesa, është e Qeverisë, ju lutem. Vendimin nuk mund ta marrë Qeveria, e merr Kuvendi. Prandaj, s'kemi çfarë të paragjykojmë. Vendimin e merr Kuvendi, prandaj të jemi pak më shumë të përqendruar në temë. Fjalën e ka deputetja e fundit për diskutim, Synavere Rysha.

SYNAVERE RYSHA: Faleminderit, Kryetar!

Unë do të kërkoj njëherë një sqarim rreth mbiemrit tim, sepse vazhdimisht po e thoni gabim, e që nuk po e di a është shkruar gabim apo ju e theksoni gabimisht. Kisha pasur dëshirë ta lexoni mbiemrin ashtu sikur që është. Por, nëse është gabim, kërkoj falje.

(Ndërhyrje e Kryetarit – nuk dëgjohet për transkriptim)

Po, por ju po e lexoni ndryshe. Mirë dhe shpresoj se herëve të tjera nuk do të gaboni.

Nuk e pata ndërmend ta marr fjalën, duke pasur parasysh faktin se përfaqësuesi i Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Dardanisë e sqaroi mjaft mirë dhe arsyetoi pse nuk duhet kjo kërkesë të përkrahet. Është ky një propozim shumë i qëndrueshëm dhe shumë me vend: Përderisa nuk dihet titullari i pronës, nuk di si guxon Qeveria, si mundet Qeveria të investojë në një pronë të tillë. Prandaj, tashmë kemi Agjencinë Kosovare të Privatizimit, që është i thirrur dhe unë e kuptoj se me negociata të ndryshme ka pasur mundësi ndoshta të veprohet më ndryshe, por në këtë formë si mendon Qeveria të futet në investime është rrezik që nga 11 milion, edhe nga 7,5 milion pra rreth 18,5 milionë euro të na shkojnë mjete të humbura dhe pastaj të kërkojmë përgjegjësi dhe për këtë të ngritën nga opozita komisione hetuese apo edhe nga deputetët në Kuvend.

Një çështje që u trajtua dhe u ngrit këtu është se ne, sikur po harrojmë që Kosova po kalon në fazën e tranzicionit, prandaj e kemi pasur çështjen e ndryshimit të statusit të Kosovës. Pas pavarësimit, një çështje tjetër mjaft e rëndësishme është edhe ndryshimi i pronës. Për momentin, në Kosovë ekzistojnë 3 lloje të pronave, sepse unë po e ndiej obligim ta cek këtu, sepse ndoshta sikur u ngatërruam edhe nga kolegët e pozitës. Për momentin është prona private dhe ajo publike që do të ekzistojnë edhe më tutje dhe prona shoqërore, që është në fazën e tranzicionit. Prandaj, në këtë pjesë bie edhe kompleksi i “Rilindjes” dhe nuk di si ne guxojmë ta bëjmë një çështje të tillë dhe si guxojmë të investojmë. Çuditërisht që njerëzit e thirrur, njerëzit e profesionit, i bëjnë këto ndryshime dhe guxojnë të thonë se Ligji për ndërmarrjet publike i përfshin edhe ndërmarrjet shoqërore.

Prandaj, ne Agjencisë Kosovare të Privatizimit ia kemi besuar si Kuvend ta bëjë privatizimin e pronës në Kosovë. Se çka do të ndodhë me kompleksin e “Rilindjes” do të jetë çështje e diskutueshme.

Prandaj, ne si LDD kërkojmë që, së pari të definohet prona, e pastaj të vazhdohet me investime dhe mos të hedhim investime vend e pavend, sepse edhe për këto 8 milion, pastaj, do të detyrohemi ne si LDD të kërkojmë për t'u hetuar investimi i këtyre mjeteve. Me procedura të shpejta dhe të pavend, nuk jemi për t'i përkrahur. Përndryshe, për atë që po ndodhë, e po paguhen qira për objekte private, jemi kundër atyre gjërave, por fatkeqësisht se Kosova nuk ka objekte të tjera. Unë nuk e di pse Qeveria nuk po mendon të fillojë Kompleksin e ri të Qeverisë në faza, të fillojë në fazën e parë e të vazhdojë, sepse kuptohet gjithçka duhet të shkojë në faza, e jo të futë mjete të pasigurta dhe të

cilave nuk iu dihet fundi. Prandaj, edhe unë personalisht dhe Grupi im nuk do ta përkrahim një kërkesë të tillë, përderisa nuk do të definohet çështja e pronës. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Nuk kemi diskutues të tjerë. Qeveria ka pasur të drejtë ta bëjë kërkesën. Qeveria e ka arsyetuar kërkesën, me ligj ka të drejtë, vendimi merret nga Kuvendi. Prandaj, lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim dhe votojmë tash:

Do të thotë, 19 janë “për”, 33 janë “kundër”, 15 abstenime, do të thotë nuk kalon.

Konstatoj se kërkesa për ridestitim e Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave, për investime kapitale nga projekti: “Kompleksi i ri qeveritar”, për projektin e “Renovimit të Pallatit të Mediave”, nuk kalon. Ju faleminderit!

Kalojmë në pikën e tetë të rendit të ditës:

– Shqyrtimi i rekomandimit të Organit të Pavarur Përzgjedhës për emërimin e anëtarëve të Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik

Qeveria e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 96 pika 4 të Ligjit për prokurim publik, ia ka propozuar Kuvendit Listën e kandidatëve për anëtarë të Organit Shqyrtues të Prokurimit.

Organi i pavarur për përzgjedhjen e anëtarëve të Organit Shqyrtues të Prokurimit, në pajtim me Vendimin e Kuvendit të datës 16 maj 2008, ka shqyrtuar listën për 5 kandidatë, të propozuar nga Qeveria, për anëtarë të Organit Shqyrtues të Prokurimit dhe Kuvendit ia ka rekomanduar listën për 3 kandidatë për anëtarë të Organit Shqyrtues të Prokurimit, si vijon:

- Hysni Hoxha,
- Tefik Sylejmani dhe
- Demë Keka.

Dy kandidatët e tjerë, nga 5 të propozuarit, aq sa janë paraparë me Ligj, Ahmet Krasniqi dhe Lulzim Blakaj, sipas Rrganit të pavarur të përzgjedhjes nuk i kanë plotësuar kushtet e parapara në nenin 96 pika 5 të Ligjit për prokurimin publik.

Si po duket, nga shefat e grupeve parlamentare s’e ka kërkuar askush fjalën. Urdhëroni, Haki Shatri, e ka fjalën!

HAKI SHATRI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës e vlerëson pozitivisht angazhimin që të kompletohet Organi Shqyrtues i Prokurimit, sepse me ligj ka kaluar afati i përcaktuar kohor dhe janë bllokuar lëndët të cilat duhet të rishqyrtohen në komisionin rregullativ, në organin shqyrtues. Mirëpo, meqenëse organi i pavarur për përzgjedhje nuk e ka ofruar listën complete me 5 anëtarë të organit shqyrtues, kurse vetëm 3 anëtarë të organit shqyrtues, sipas ligjit, nuk mund të funksionojnë, kërkojmë që organi i pavarur

për përzgjedhje të komplotojë listën me 5 kandidatë të cilët i plotësojnë kushtet e parapara me ligj.

Kjo është brenga jonë dhe vërejtja jonë e parë në propozim dhe në pajtim me konsultimet që kemi bërë me zëvendëskryeministrin që vjen nga Lidhja Demokratike e Kosovës, për Grupin Parlamentar, kërkohet edhe një afat i shkurtër plotësues kohe, në mënyrë që biografitë e disa nga këta kandidatë të ofruar t'i shqyrtojmë sepse ne që sot i kemi marrë listat, me biografitë dhe emrat e kandidatëve dhe nuk kemi pasur kohë t'i shqyrtojmë biografitë në tërësi dhe të dimë realisht a i plotësojnë kriteret e përcaktuara me ligj.

Pra, kërkojmë që në një afat sa më të shkurtër, ndoshta deri në mbledhjen e ardhshme, të kemi listën e plotë dhe ta shqyrtojmë e miratojmë në këtë Kuvend. Faleminderit!

KRYETARI: Sipas nenit 96 pika 1 të Ligjit për prokurimin publik, Organi Shqyrtues i Prokurimit përbëhet prej 5 anëtarëve. Organi i Pavarur Përzgjedhës i ka propozuar 3 anëtarë dhe Kuvendi duhet të kërkojë nga Qeveria që t'i propozojë kandidatët e tjerë për ta plotësuar Organin Shqyrtues të Prokurimit.

Mandati fillestar i anëtarëve të Organit Shqyrtues të Prokurimit është 5 vjet për kryetarin dhe për dy anëtarë, ndërsa 4 vjet për dy anëtarë të tjerë.

Ne kemi menduar ta shqyrtojmë këtë si çështje të ngutshme, sepse kjo çështje me ligj është dashur të kryhet në fund të vitit të kaluar dhe në fillim të këtij viti të ishte kryer kjo çështje dhe sot e kemi sjellë këtu që vërtet ta bëjmë funksional organin për t'i kryer detyrat dhe përgjegjësitë e veta, sepse edhe ashtu jemi vonuar. Kjo ka qenë arsyeja dhe dy kandidatët tjerë, kemi menduar, në ndërkohë Qeveria t'i propozojë dhe ne ia dërgojmë organit të përzgjedhjes dhe pastaj në një afat tjetër edhe do ta komplotojmë këtë organ. Mendoj se për 3 veta, për fillim, mund të funksionojnë. Ardian Gjini e ka kërkuar fjalën.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Duhet të them se arsyeja e parë është ajo që u tha edhe më parë. Sot deputetët e kanë marrë materialin për këtë pikë të rendit të ditës, por kërkohet prej Kuvendi që të marrë vendimin, kurse deputetët të votojnë dhe përderisa është tepër e qartë se nuk kanë pasur kohë ta konsultojnë as materialin, as të dinë se kush janë kandidatët të cilët propozohen për një trup tepër të rëndësishëm të funksionimit të sistemit demokratik në Kosovë. Ne nuk mund ta votojmë si të këtillë.

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Regjia, fjalën mund t'ia vazhdoni deputetit për diskutim.

ARDIAN GJINI: Kërkojmë që të merret më tepër kohë për këtë çështje dhe nëse është pritur 6 muaj, nuk kemi nevojë që t'i thyejmë të gjitha rregullat e të mos presim, shembull të marrim, edhe deri në fillim të javës së ardhshme. Mendoj se nuk është mirë të na ndodhë kështu në Kuvend të Kosovës që, me kaq nguti të na parashtrohet një zgjidhje, për të cilën, edhe ju vetë e thatë, ka qenë dashur të kryhet para 6 muajve. Pse t'i thyejmë rregullat tash. Mendoj se nuk do të ishte problem të pritet edhe për një kohë, sepse nuk kemi arritur të dimë se kush janë këta njerëz. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Ne do të thotë e aprovuam këtë për t'u shqyrtuar si rend dite me urgjencë, nën një.

Dhe, nën dy. Ju e dini që organin përzgjedhës e kemi votuar në këtë Kuvend, para një kohe dhe organi që ne e kemi votuar e ka bërë këtë propozim dhe vërtet, edhe një herë po them, është çështje shumë e ngutshme dhe nuk kemi mundësi të bëjmë përzgjedhje tjera, sepse jemi vonuar në këtë drejtim.
Lulzim Zeneli e ka fjalën.

LULZIM ZENELI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Po i bashkëngjitem parafolësit, do të thotë edhe parafolësve më herët, se për një vendim të tillë nevojitet të paktën, jo në aspektin procedural, por në aspektin e kohës, të kemi konsultime paraprake qoftë si deputetë, qoftë edhe si grupe parlamentare.

Mendoj dhe jemi të bindur të gjithë se për një vendim të tillë nevojitet një trajtim shumë më serioz, për vetë faktin se secili organ që po nxirret nga ky Kuvend, po adreson përgjegjësi shumë të mëdha për çka secili deputet është përgjegjës për votën që e drejton. Prandaj, kërkoj që kjo çështje të trajtohet me seriozitetin shumë më të madh dhe për këtë nevojitet kohë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Lutfi Haziri, e ka fjalën.

LUTFI HAZIRI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Mendoj se arsyet që u paraqitën në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së qëndrojnë. Unë ju kisha lutur ta shfrytëzoni të drejtën tuaj si Kryetar i Kuvendit dhe sipas Rregullores që, në marrëveshje me shëfat e grupeve parlamentare ta shtyni këtë rend të punës, sepse vota kundër këtyre kandidatëve e pamundëson që këta kandidatë të hyjnë në përzgjedhje. Nuk kemi asnjë problem tjetër pos nevojës të plotësohet vendimi, nevojës të jenë të njoftuar deputetët sepse është një komision shumë i përfolur në të kaluarën e afërt. Ne kemi mbështetur idenë e sjelljes së njerëzve kompetent, të mirë, të drejtë, të pranueshëm sepse ky komision famoz, në të kaluarën e afërt, ka lejuar që 35% të buxhetit në investime të mos shpenzohet duke porositur ankesa përditë. Është komision i ndjeshëm dhe unë ju lus që nëse kemi pajtimin e shëfave të grupeve parlamentare të mos i pamundësojmë të jenë këta njerëz duke i votuar, por të krijohet mundësi që në seancën e ardhshme të kompletohet komisioni dhe ne të mbështesim vendimin e Qeverisë për funksionalizimin e këtij komisioni, shumë jetik dhe të domosdoshëm në zbatimin e ligjit.

KRYETARI: Unë dua ta jap një sqarim. Në seancën e ardhshme, dhe jo në këtë pjesë para pushimeve verore, mund të na vijnë 5 kandidatët, sepse ju e dini që është një procedurë bukur e gjatë për t'u propozuar ata. Duhet pra t'i propozojë Qeveria, duhet të shkojnë në komisionin përzgjedhës, pastaj duhet komisioni përzgjedhës t'i marrë edhe njëherë në shqyrtim. Megjithatë, ne mund ta shtyjmë për seancën tjetër, edhe pse, thamë në fillim se, për arsye të urgjencës që ka emërimi i Organit Shqyrtues të Prokurimit publik propozuam që të hyjë në rend të ditës me urgjencë – shqyrtimi i rekomandimit të organit të pavarur të përzgjedhjes, organ që është votuar këtu dhe ne atij organi ia kemi besuar të bëjë përzgjedhjen dhe nga 5 kandidatë që kanë qenë të propozuar nga Qeveria, 3 ia ka propozuar Kuvendit për t'i miratuar dhe 2 nuk ia ka propozuar Kuvendit. Ky është rezultati që na kanë sjellë deri më tani.

Edhe njëherë po ju them, se kjo çështje, vërtet, do kohë dhe do të duhej, për shkak të punëve të mëdha që janë, të konstituohet organi e pastaj përgjegjësitë tjera janë të Qeverisë dhe të Parlamentit. Mirëpo, nëse grupet parlamentare kërkojnë që të shtyhet, unë s'kam kundër dhe e shtyjme. Ramë Buja, e ka fjalën.

RAMË BUJA: Zoti, Kryetar!

Kolegë të nderuar deputetë,

Unë nuk desha ta marr fjalën për faktin se ne e votuam rendin e ditës, u sqarua urgjenca dhe lus kolegët e mi deputetë që kur të votojmë për rendin e ditës, të kemi parasysh gjithmonë se çfarë po votojmë. Ky është një “defekt” i vogël, nëse mund ta quaj kështu. Mirëpo, meqë të gjithë kolegët e mi – shefat e grupeve, arsyetuan se pse nuk do të duhej votuar sot këtë pjesë të kësaj tërësie të këtij mekanizmi – edhe unë jam me ta, për arsyen që edhe pse ka një sqarim këtu dhe sqarimi është meqë me ligj 3 nga këta zgjedhën për 5 vjet dhe 2 për 4 vjet, megjithatë mund ta kishim bërë. Por, meqë të tjerët janë unik rreth kësaj që të na vijë lista e plotë, që konsideroj se jemi vonuar tepër shumë, por edhe për një javë nuk bëhet shumë. Unë uroj dhe dëshiroj që kjo punë të bëhet brenda javës, edhe pse dyshoj shumë. Faleminderit!

KRYETARI: Unë dua ta përsëris këtë edhe njëherë. Deri më 29 qershor Kuvendi ose duhet këtyre kandidatëve tua jap vizën, ose ta zgjasë mandatin e atyre që tha edhe shefi i Grupit të LDK-së se e kanë penguar vërtet shfrytëzimin e buxhetit, t'u zgjatet mandati njerëzve që mendohet se kanë një përgjegjësi.

(Ndërhyrje – s'dëgjohet për transkriptim)

Jo, unë s'jam vonuar, por procedurat janë këto që janë dhe unë e kam shtruar këtë si me urgjencë këtu.

(Ndërhyrje)

Ne, lëndën, ju lus, nga Komisioni që e kemi përzgjedhur, ne e kemi marrë më 17.6 dhe më 18. 6 ju e keni pasur në kutitë tuaja dhe sot jemi në seancë me datën 19.6. Do të thotë, kjo ka qenë puna jonë që e kemi bërë dhe ne s'jemi vonuar. Unë kisha kërkuar që shefat e grupeve parlamentare edhe një herë të konsultohen për 5 minuta, kurse ne po i presim të na njoftojnë për këtë. Urdhëroni, Rita! Rita Hajzeraj!

RITA HAJZERAJ: Faleminderit, zoti Kryetar!

Unë mendoj se nuk është e mjaftueshme një ditë që t'i shqyrtojmë biografitë e këtyre njerëzve, andaj Grupi Parlamentar i AKR-së mendon se kjo çështje duhet të shtyhet për një seancë të ardhme, ose të paktën për një javë. Faleminderit!

KRYETARI: Urdhëroni, Ramë! Ramë Buja e ka fjalën.

RAMË BUJA: Zoti Kryetar!

Unë besoj se është shumë e domosdoshme, meqë është disponimi çfarë është, po shihet se për një javë të shtyhet, pavarësisht ne mund ta bëjmë numrin 5 a s'mund ta bëjmë, së paku për 3 biografi të njerëzve të sqarohemi dhe përsëri të mendojmë për këtë punë. Por, sot po shihet disponimi se çfarë është, prandaj ju kisha lutur të mos lodhemi për këtë gjë.

KRYETARI: Faleminderit! Unë përsëri po them, s'e kam problemin tim, por ju e dini që ai komision që na i ka propozuar këta, ne i kemi përzgjedhur, por, megjithatë unë respektoj mendimet e shefave të grupeve dhe këtë e shtyjme për seancë të ardhshme. Pra, mirupafshim në seancën e ardhshme!

E përgatiti:

Njësia e Transkripteve